
بسم الله الرحمن الرحيم

NË TRYEZËN E KUR'ANIT DHE SUNNETIT



Autori: Xhafer SUBHANI

Tiranë, 2014

Titulli**: Në tryezën e Kur'anit dhe Sunnetit**

Autori: **Xhafer SUBHANI**

Përktheu: Vullnet **MERJA**
E redaktoi: Jerida **KULLA**

Korrektura teknike: Vjollca **KARAJ**
Korrektura letrare: Sonila **QAZIMI**

Përkujdesja kompjuterike: Sabrie **FEZA**
Kopertina: Sabrie **FEZA**
Botoi: SHOQATA **"FLLADI"**

ME EMRIN E ALLAHUT, TË GJITHËMËSHIRSHMIT, MËSHIRËPLOTIT!

Falënderimet i takojnë Zotit të botëve. Paqja dhe bekimet qofshin mbi Profetin Muhamed, mbi familjen e tij të pastër dhe mbi shokët e tij të zgjedhur.

Ne myslimanët grindemi për çështje të brendshme, ndërkohë që armiqtë e Islamit na kanë përçarë nga jashtë në atë mënyrë sa ne nuk e ndiejmë. Ne jemi dobësuar për të mbrojtur vendet tona dhe armiqtë na kanë sunduar. Allahu i Madhëruar thotë: **"Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe mos u grindni ndërmjet jush, sepse do të humbni guximin e do t'ju lërë fuqia. Bëhuni të durueshëm, se Allahu, me të vërtetë, është me të durueshmit."**[1]

وَأَطِيعُواْ ٱللَّهَ وَرَسُولَهُۥ وَلَا تَنَٰزَعُواْ فَتَفۡشَلُواْ وَتَذۡهَبَ رِيحُكُمۡۖ ... ﴿٤٦﴾

Sot, në këto ditë dhe në çdo kohë, ne duhet të kthehemi te Libri (Kur'ani) dhe Suneti, fjalët, veprat dhe miratimet e Profetit Muhamed *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* për mosmarrëveshjet që

[1] Sure "En Enfal", ajeti 46.

kemi dhe të bashkojmë fjalën tonë rreth këtyre dy burimeve, ashtu siç thotë Allahu i Madhëruar: **"…Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit…"**[2]

...فَإِن تَنَٰزَعۡتُمۡ فِي شَيۡءٖ فَرُدُّوهُ إِلَى ٱللَّهِ وَٱلرَّسُولِ... ۝٥٩

Në këtë seri hulumtimesh do të bazohemi te Libri dhe Suneti, për të nxjerrë prej tyre çështjet që janë të papajtueshme për ne. Le të jenë këto hulumtime, me lejen e Allahut Fuqiplotë, faktorë të bashkimit të fjalës sonë.

Shpresojmë që dijetarët të bashkohen me ne në këtë fushë dhe së bashku të përpiqemi të shkulim rrënjët e mosmarrëveshjeve e të mospajtimeve. Le të mbjellim në vend të tyre farën e dashurisë, të mirëkuptimit dhe të unitetit. Vërtet, Allahu është Mbarësuesi dhe Atij i mbështetemi për gjithçka.

[2] Sure "En-Nisa", ajeti 5.

SALAVATI MBI PROFETIN MUHAMED DHE FAMILJEN E TIJ

(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)

Allahu i Madhëruar thotë: **"Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin që engjëjt e Tij luten për atë. O besimtarë, lutuni për atë dhe përshëndeteni me "selam"!"**[3]

إِنَّ ٱللَّهَ وَمَلَٰٓئِكَتَهُۥ يُصَلُّونَ عَلَى ٱلنَّبِيِّۚ يَٰٓأَيُّهَا ٱلَّذِينَ ءَامَنُواْ صَلُّواْ عَلَيۡهِ وَسَلِّمُواْ تَسۡلِيمًا ﴿٥٦﴾

Dhe: "**Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun."**[4]

لَّقَدۡ كَانَ لَكُمۡ فِي رَسُولِ ٱللَّهِ أُسۡوَةٌ حَسَنَةٞ لِّمَن كَانَ يَرۡجُواْ ٱللَّهَ وَٱلۡيَوۡمَ ٱلۡأٓخِرَ وَذَكَرَ ٱللَّهَ كَثِيرٗا ﴿٢١﴾

[3] Sure "El-Ahzab", ajeti 56.

[4] Sure "El-Ahzab", ajeti 21.

MIRËSITË E SALAVATIT MBI PROFETIN DHE FAMILJEN E TIJ (*Paqja e Allahut qoftë mbi të gjithë ata!)*

1- Në librin "Kenzul Ummal" lexojmë:

Është përcjellë nga Hasani, se Profeti Muhamed *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: "Shtojeni salavatin për mua, sepse salavati juaj për mua është falje për gjynahet tuaja."[5]

Ebu Dardau transmeton se Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Ai që bie në salavat për mua dhjetë herë kur gdhihet dhe kur ngryset dhjetë herë, e përfshin ndërmjetësimi (shefati) im."*[6]

Sehl ibn Sa'di ka thënë: "Kur erdhi i Dërguari i Allahut, Ebu Talha u ngrit, e takoi dhe i tha: *"Ti je nëna dhe babai im. Unë po shoh gëzim në fytyrën tënde."* Profeti i tha: "Pak më parë më erdhi Xhebraili e më tha: "*O Muhamed. Ai që bie në salavat për ty një herë, Allahu do t'i shkruajë atij dhjetë të mira, do t'i fshijë atij dhjetë të këqija dhe do ta lartësojë me dhjetë shkallë për hir të atij salavati."*[7]

---

[5]" Kenzul Ummal", 1: 436.

[6]" Kenzul Ummal", 1: 436.

[7] "Kenzul Ummal", 1:436, 447 dhe 2:179. Hadithi është përcjellë nga Ebu Talha me shtesën: "Engjëlli i tha atij njësoj si të tha ty. Unë i thashë: "O Xhebrail. Kush është ai engjëll?" Ai tha: "Allahu i Madhëruar, që nga koha e krijimit tënd e deri në ringjallje ka caktuar

2- Në Sahihun e Muslimit, Sunenin e Termidhiut, Sunenin e Nisaiut, në Musnedin e Et Tajalisij, etj.:

Është përcjellë nga Ebu Hurejra se i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Ai që bie në salavat për mua një herë, Allahu do të bjerë në salavat për të dhjetë herë."*[8]

3- Në librin "Kenzul Ummal":

Transmetohet nga Amar ibn Jasiri se Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Allahu i ka dhënë një engjëlli prej engjëjve dëgjimin e krijesave. Ai engjëll qëndron te varri im deri në Ditën e Kiametit. Kushdo që bie në salavat për mua, ai thotë emrin e tij dhe emrin e babait të tij dhe thotë: "O Muhamed, filani, i biri i filanit, ra salavat për ty. Zoti im më ka siguruar se do t'i përgjigjet me dhjetë salavate atij që bie në salavat."*[9]

4- Në sunenin e Ebu Daudit, Termidhiut, Nisait, Musnedi i Ahmedit dhe Mustedreku, dhe trajta e hadithit është sipas të parit (suneni i Ebu Daudit):

---

për ty dy engjëj. Ai që bie në salavat për ty, i thuhet: "Allahu bie në salavat për të!""; "Kenzul Ummal", 1:440,449 dhe 2:181. Hadithi është përcjellë edhe nga Said ibn Umer el Ensarij dhe Ebu Beredetu ibn Nejar dhe Enesi; "Kenzul Ummal", 1: 438, 448-449. *Sunen Nisai*, 3: 50, Kitabu salat, K. "El fadl fi salat ala nebij"; "Feuaid Simtijn", 1: 24; "Tarihu Bagdad", 8: 381.

[8] "Sahihu Muslim", 1: 306, Kitabu salat, kreu "Es salatu ala nebij (sal'lallahu alejhi ue alihi)". *Sunen Nisai*, 3:50, Kitabu salat, K. "El fadl fi salat ala nebij (sal'lallahu alejhi ue alihi)". *Musned et Tajalsij*, 1: 218, Hadithi nr. 2122. "Rijadu Salihin", 381. "Esbabu et Tenzijl" i Uahidij, 250. "Ed Durul Menthur", 5: 218. "Tefsijr Kurtubij", 14: 294.

[9] "Kenzul Ummal", 1: 448, 449-450.

Është transmetuar nga Fadaletu ibn Ubejd: *"I Dërguari i Allahut dëgjoi një burrë që lutej në namaz. Ai as nuk përmendte Allahun dhe as nuk binte në salavat për Profetin. Profeti i tha atij: "Ky u nxitua." Pastaj e thirri atë dhe i tha atij dhe të tjerëve: "Kur dikush prej jush të falet, të fillojë me falënderimin e Allahut e me lavdërimin e Tij, më pas të bjerë në salavat për Profetin, pastaj të lutet për çfarë të dojë."*[10]

5- Në Sunenin e Ibn Maxhah lexojmë:

Transmetohet nga Sa'ad es Saidij se Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"…Nuk i pranohet namazi ai që nuk bie në salavat për Profetin."*[11]

[10] Sunen Ebu Daud, Kitab el Uiter, K. "Lutja" (dua), 2: 77, Hadithi 1480. *Sunen Termidhi*, Kitab dua, 13: 21. Në një transmetim tjetër nga ai, Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* i tha një burri që u fal dhe u lut për veten e tij dhe nuk e falënderoi Allahun dhe as nuk ra në salavat për Profetin: "O namazfalës! Kur të falesh dhe të ulesh, falënderoje Allahun, dërgo salavat për mua dhe pastaj lutu Atij." Një tjetri i ka thënë: "Falu, falëndero Allahun dhe dërgo salavat për mua. O namazfalës! Lutu me dashuri. *Musned Ahmed*, 6: 18. *Sunen Nisai*, 3: 44, Kitabu salat, Kreu "Temxhijd" dhe *Salat ala nebij* në namaz. "El Mustedrek" i Hakimit, 1: 268. "Rijadu Salihijn" i Neueui: 382.

[11] Sunen ibn Maxhah, Kitabu taharati, Kreu "Ma xhae fi tesmijeti fi el udu", 1: 140, Hadithi 400.

6- Në librin "Kenzul Ummal":

Transmetohet nga Xhabir se Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Ai, në të cilin unë përmendem dhe nuk bie në salavat për mua, do të jetë i ligë."*[12]

Nga Husejn ibn Ali transmetohet se Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Ai në të cilin unë përmendem dhe anashkalon salavatin për mua, anashkalon rrugën e Xhenetit."*[13]

7- Në Musnedin e Ahmedit dhe Sunenin e Termidhiut e në të tjerë lexojmë:

Është transmetuar nga Husejn ibn Ali se Profeti Muhamed *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Koprrac është ai, në prani të të cilit unë përmendem dhe nuk bie në salavat për mua."*[14]

---

[12] "Kenzul Ummal", 1: 438.

[13] "Kenzul Ummal", 1: 438 transmetuar nga Tabaranij. Të njëjtin me këtë hadith e transmeton edhe Ibn Abasi, 1: 438. Tefsir "Ed Durul Menthur", 5: 218. Ibn Maxhah: 294.

[14] "Musnedi i Ahmedit", 1:201. *Sunen Termidhi*, Kitabu dua, Kreu, "Thënia e Profetit": "Me gjithë mendjemadhësinë e njeriut", 13: 62-63. El Mutekij në "Kenzul Ummal", 1: 437. Nga Hasani: "Hadithin e ka transmetuar Ahmedi, Termidhiu, Nisai dhe ibn Haban në Sahihun e tij." Të njëjtë me këtë hadith e përcjell Auf ibn Malik, El Hasan, Xhabir, Ebu Hurejra dhe Kudate në "Kenzul Ummal", 1: 436, 437, 438, 453. Tefsir "Ed Dururl Menthur", 5: 218. "Rijadu Salihin": 382.

MËNYRA E SALAVATIT PËR PROFETIN MUHAMED

(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)

1- Në "Kenzul Ummal" lexojmë:

Nga Ali ibn Ebu Talib transmetohet: "I thanë të Dërguarit: "O i Dërguari i Allahut, si të biem në salavat për ty?" Ai u tha: "Thoni: *"O Zot bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, njësoj siç bekove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Vërtet, Ti je Falënderues dhe i Lartë. Mirësoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, siç mirësove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Vërtet, Ti je Falënderues dhe i Lartë."*[15]

2- Në Sahihun Muslim, në Sunen ebu Daud, në Sunen Termidhi, në Sunen Nisai, në Meuta të Malikut, në Musnedin Ahmed dhe në sunen ed Darimij lexojmë:

Transmetohet nga Ebi Mes'ud el Ensarij: "Profeti erdhi dhe u ul me ne në mexhlisin e Sa'd ibn Ibadetut. Beshir ibn Sa'di, që është Ebu Nu'man ibn Beshir, i tha Profetit: "Allahu na urdhëroi që të biem në salavat për ty, o i Dërguari i Allahut. Si të biem në salavat për ty?"

[15]Tefsir "Ed Durul Menthur", 5: 217. "Kenzul Ummal", 2: 176.

Ebu Mes'ud el Ensarij tha: "Profeti heshti deri sa ne uruam që më mirë të mos e kishte pyetur. Pastaj tha: "Thoni: "*O Zot bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, njësoj siç bekove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit në të gjitha botët. Mirësoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, siç mirësove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Vërtet, Ti je Falënderues dhe i Lartë. Përshëndetja (selami) është ashtu siç e mësuat."*[16]

3- Në Sahihun Buhari, në Sunen Nisai, Ibn Maxhah dhe në Musnedin e Ahmedit lexojmë:

Transmetohet nga Ebu Said el Huderij: "I thamë të Dërguarit të Allahut: "O i Dërguari i Allahut. Selamin për ty e mësuam. Si është salavati?" Ai tha: "Thoni: "O Zot bekoje Muhamedin, robin Tënd, të Dërguarin Tënd dhe familjen e Muhamedit, njësoj siç bekove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Mirësoje Muhamedin dhe familjen e

[16] Sahihu Muslim, Kitabu salat, K. "Salat ala nebij ba'de teshehud", 1: 305, Hadithi 65. *Sunen Ed Darimij*, Kitabu salat, K. "Salat ala nebij", 1: 301. *Sunen Ebi Daud*, Kitabu salat, K. "Salat ala nebij ba'de teshehud", 1: 258, Hadithi 980. *Sunen Nisai*, Kitabu sehv, K. "El emr bi salat ala nebij ue alihi", 3: 45-46, ue babu kejfijetu salat ala nebij ue alihi, 3: 47. *Sunen Termidhij*, Kitabu tefsir, suretu "*El-Ahzab*", 12: 95. *Meuta Malik*, Kitab kasru salat fi sefer, K. "Ma xhae fi salat ala nebij", 1: 165-166. Musned Ahmed, 5: 274. "Kenzul Ummal", 2: 182. Tefsir "Kurtubi", 14: 233. Tefsir "Ed Durul Menthur", 5: 216. Tefsir "Ibn Kethir", 3: 508. Tefsir "El Hazin", 3: 477. "Mustedrek Sahihejn", 1: 268. *Sunen Bejhakij*, 2: 378.

Muhamedit, siç mirësove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit.""[17]

4- Në tefsirin e Tabarit dhe të Sujutit lexojmë:

Transmetohet nga Ibn Abasi: *"… thamë ose thanë: "O i Dërguari i Allahut! E mësuam selamin për ty, por si të biem në salavat për ty?"* Ai tha: *"Thoni: "O Zot, bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, njësoj siç bekove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Vërtet, Ti je Falënderues dhe i Lartë. Mirësoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, siç mirësove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Vërtet, Ti je Falënderues dhe i Lartë."*[18]

5- Në sunen Nisai lexojmë:

Zejd ibn Harixhetu transmeton se Profeti, ka thënë: *"Bini në salavat për mua, bëni sa më shumë dua dhe thoni: "O Zot, bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, njësoj siç bekove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Vërtet, Ti je Falënderues dhe i Lartë. Mirësoje Muhamedin dhe familjen e*

---

[17]"Sahihu Buhari", Kitab tefsir, tefsir suretu "El-Ahzab", K. "Thënia e Allahut": **"Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e Tij luten për atë…"**, 3: 119; dhe Kitabu da'uat, K. "Salat ala nebij", 4: 72. *Sunen Nisai*, Kitabu sehv, K. "Kejfijetu salat ala nebij", 3: 49. *Sunen ibn Maxhah*, Kitab ikametu salat, K. "Salat ala nebij", 1: 292, Hadithi 902. Musned Ahmed, 3: 47. Tefsir "Ed Durul Menthur", 5: 217.

[18] Tefsir "Tabarij", komentimi i ajetit prej sures "El-Ahzab", 22: 31. Tefsir "Ed Durul Menthur", 5: 216.

Muhamedit, siç mirësove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Vërtet, Ti je Falënderues dhe i Lartë."[19]

6- Në Sunen Nisai dhe në Musnedin e Ahmedit lexojmë:

Nga Ebu Talhatu transmetohet: *"Ne i thamë: "O i Dërguari i Allahut. Si është salavati për ty?"* Ai tha: *"Thoni: "O Zot, bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, njësoj siç bekove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Vërtet, Ti je Falënderues dhe i Lartë. Mirësoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, siç mirësove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Vërtet, Ti je Falënderues dhe i Lartë."*[20]

Në një transmetim tjetër thuhet: *"Një burrë shkoi tek Profeti dhe i tha: "Si të biem në salavat për ty o i Dërguari i Allahut?"* Ai tha: *"O Zot, bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, njësoj siç bekove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Vërtet, Ti je Falënderues dhe i Lartë. Mirësoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, siç mirësove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Vërtet, Ti je Falënderues dhe i Lartë."*[21]

---

[19] Tefsir "Tabarij", komentimi i ajetit prej sures "El-Ahzab", 22: 31. Tefsir "Ed Durul Menthur", 5: 216.

[20] Tefsir "Tabarij", komentimi i ajetit prej sures "El-Ahzab", 22: 31. Tefsir "Ed Durul Menthur", 5: 216.

[21] Tefsir "Tabarij", komentimi i ajetit prej sures "El-Ahzab", 22: 31. Tefsir "Ed Durul Menthur", 5: 216.

7- Në "Kenzul Ummal":

Transmetohet nga Talhatu: "Ne i thamë: *"O i Dërguari i Allahut. Vërtet, e mësuam selamin tënd. Si është salavati për ty?"* Ai tha: *"O Zot, bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, njësoj siç bekove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Vërtet, Ti je Falënderues dhe i Lartë. Mirësoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, siç mirësove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Vërtet, Ti je Falënderues dhe i Lartë."*[22]

8- Në Sahihun e Buhariut dhe të Muslimit, në Sunenin e Ebiu Daudit, në Sunenin e Ed Deramijit, në Sunenin e Nisaij, në Sunenin e Termidhij, Ibn Maxheh, Musnedin e Ahmedit, Tabarij dhe Sujuti në komentimet e tyre:

Transmetohet nga Ka'b ibn Axhezetu: *"Isha ulur te Profeti dhe erdhi një burrë e i tha: "Vërtet e mësuam si të të dërgojmë selam ty, o i Dërguari i Allahut. Si të biem në salavat për ty?"* Ai i tha: *"O Zot, bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, njësoj siç bekove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Vërtet, Ti je Falënderues dhe i Lartë. Mirësoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, siç mirësove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Vërtet, Ti je Falënderues dhe i Lartë."*[23]

---

[22] Tefsir "Tabarij", komentimi i ajetit prej sures "El-Ahzab", 22: 31. Tefsir "Ed Durul Menthur", 5: 216.

[23] Tefsir "Tabarij", komentimi i ajetit prej sures "El-Ahzab", 22: 31. Tefsir "Ed Durul Menthur", 5: 216.

9- **Në Musnedin Ahmed dhe në "Ed Durul Menthur" lexojmë:**

El Beridetu el Huzai transmeton nga Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: Thoni: *"O Zot, dërgoje bekimin, mëshirën dhe mirësinë Tënde mbi Muhamedin dhe mbi familjen e Muhamedit, siç i dërgove për Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Vërtet, Ti je i Falënderuar dhe i Lartë."*[24]

10- Në "Kenzul Ummal" lexojmë:

Është transmetuar nga Muhamed Ibn Abdullah ibn Zejd, se Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"O Zot, bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, njësoj siç bekove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Vërtet, Ti je Falënderues dhe i Lartë. Mirësoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, siç mirësove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Vërtet, Ti je Falënderues dhe i Lartë."*[25]

11- Në tefsirin e Tabarij dhe Sujutit:

Transmetohet nga Ibrahimi për thënien e Allahut: **"Vërtet, Allahu dhe engjëjt e Tij…"** se e kanë pyetur

[24] Musned Ahmed, 5: 353. Tefsir "Ed Durul Menthur", 5: 218. "Kenzul Ummal", 1: 442.

[25] Tefsir "Tabarij", komentimi i ajetit prej sures "El-Ahzab", 22: 31. Tefsir "Ed Durul Menthur", 5: 216.

Profetin: *"O i Dërguari i Allahut! Selamin e mësuam. Si është salavati për ty?"* Ai tha: "Thoni: *"O Zot! Bekoje Muhamedin, robin Tënd, të Dërguarin tënd dhe Ehli Bejtin (Familjen) e tij, siç bekove Ibrahimin. Vërtet, Ti je i Falënderuari dhe i Larti."*[26]

12- Në "Kenzul Ummal" lexojmë:

Transmetohet nga nëna e bwesimtarëve, Aisheja: "Shokët e Profetit kanë thënë: *"O i Dërguari i Allahut! U urdhëruam që të shtojmë salavatet për ty natën e errët dhe ditën e ndritur*[27] *dhe mënyra më e mirë për të rënë në salavat për ty është ashtu siç ti do të dëshiroje."* Ai tha: Thoni: *"O Zot, bekoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, njësoj siç bekove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Vërtet, Ti je Falënderues dhe i Lartë. Mirësoje Muhamedin dhe familjen e Muhamedit, siç mirësove Ibrahimin dhe familjen e Ibrahimit. Vërtet, Ti je Falënderues dhe i Lartë."*[28]

[26] Tefsir "Tabarij", 2: 32. Tefsiri "Ed Durul Menthur", 5: 216.

[27] Këto janë vetëm cilësime të ditës dhe të natës, sepse dërgimi i salavatit për Profetin nuk ka kohë të kufizuar. (Sh. P.)

[28] Tefsir "Tabarij", komentimi i ajetit prej sures "El-Ahzab", 22: 31. Tefsir "Ed Durul Menthur", 5: 216.

FESTIMET NË PËRKUJTIM TË PROFETËVE DHE NJERËZVE TË MIRË TË ALLAHUT TË MADHËRUAR

Allahu i Madhëruar thotë: **"Po, kështu është! Ndërsa kush madhëron shenjat e fesë së Allahut, tregon përkushtimin e zemrës së tij."** (Sure "Haxh", ajeti 32)

ذَٰلِكَ وَمَن يُعَظِّمْ شَعَٰٓئِرَ ٱللَّهِ فَإِنَّهَا مِن تَقْوَى ٱلْقُلُوبِ ﴿٣٢﴾

MOSPAJTIMI RRETH FESTIMEVE NË PËRKUJTIM TË PROFETËVE DHE NJERËZVE TË MIRË TË ALLAHUT

Argumentet e miratuesve të pëlqimit të festimeve

Ata që mendojnë se përkujtimi i profetëve dhe i njerëzve të mirë të Allahut të Madhëruar është i pëlqyeshëm, e argumentojnë, duke thënë se kryerja e ritualeve të Haxhit është festë në kujtim të profetëve dhe njerëzve të mirë të Allahut. Për këtë po përmendim disa shembuj:

a) **Mekami i Ibrahimit** *(Paqja qoftë mbi të!)*:

Allahu i Madhëruar thotë: "**Bëjeni vendin e Ibrahimit si vendfaljeje!"**[29]

... وَٱتَّخِذُواْ مِن مَّقَامِ إِبۡرَٰهِـۧمَ مُصَلًّى ... ﴿١٢٥﴾

[29] Sure "El-Bekare", ajeti 125.

Po përmendim shkurtimisht çfarë gjendet në Sahihun e Buhariut:[30] *"Ibrahimi dhe Ismaili (Paqja qoftë mbi të ta!), ndërtuan Shtëpinë (Qaben). Ismaili sillte gurët, ndërsa Ibrahimi ndërtonte faltoren."*

Në një transmetim tjetër, pas këtij, thuhet: *"Kur u ngrit ndërtesa, plaku ishte i dobët për transportimin e gurëve. Ai qëndronte mbi gurin e mekamit, ndërsa Ismaili i sillte gurët."*

Allahu i Madhëruar i urdhëron njerëzit që ta shohin dhe ta kujtojnë Qaben si Shtëpinë e Tij të Shenjtë, si ringjallje dhe përjetësi e kujtimit të Ibrahimit *(Paqja qoftë mbi të!)*. Në të nuk ka asgjë prej shirkut (idhujtarisë, politeizmit).

b) Safa dhe Merua:

Allahu i Madhëruar thotë: "**Kodrinat Safa dhe Merua** (në Mekë) **janë pjesë e simboleve të Allahut, prandaj ai që viziton Qaben për Haxh ose për umre, s'ka kurrfarë gjynahu nëse sillet mes tyre.**[31]

۞ إِنَّ ٱلصَّفَا وَٱلۡمَرۡوَةَ مِن شَعَآئِرِ ٱللَّهِۖ فَمَنۡ حَجَّ ٱلۡبَيۡتَ أَوِ ٱعۡتَمَرَ فَلَا جُنَاحَ عَلَيۡهِ أَن يَطَّوَّفَ بِهِمَاۚ ... ﴿١٥٨﴾

[30] Sahihu Buhari, Kitabul enbija, Babu: jezifune en neselan fil meshij, vëll. 2, f. 158-159.

[31] Sure "El-Bekare", ajeti 125.

Buhariu transmeton: *"Kur Ibrahimi (Paqja qoftë mbi të!) e la Haxhiren me djalin e saj Ismailin (Paqja qoftë mbi ata të dy!) në Mekë, asaj iu mbarua uji. Ajo u nis për të kërkuar ujë në kodrinat e Safas. U ngjit mbi të dhe filloi të kërkonte se mos shihte njeri. Por nuk pa asnjë, kështu që ajo zbriti nga Safaja, derisa arriti në luginë. Pastaj shkoi te Merua dhe u ngjit, duke shpresuar se mos shihte dikë. Këtë e bëri shtatë herë."*

Ibn Abasi ka thënë: "Profeti Muhamed *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *'Ajo është ecja e njerëzve mes tyre…'"*[32]

Allahu i Madhëruar e ka bërë ecjen mes Safasë dhe Meruasë një prej riteve të Haxhit, si shenjë ringjalljeje dhe rikujtim të veprimit të Haxhires.

c) Gjuajtja e guralecëve (remjul xhimar)

Ahmedi dhe Tajalisij, në musnesdin e tyre, transmetojnë, se i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë: *"Xhebraili e çoi Ibrahimin (Paqja qoftë mbi të!) te vend'hedhja e madhe e guralecëve (xhemeretul akabeh). Atij iu shfaq shejtani dhe Ibrahimi e goditi atë me shtatë guralecë dhe ai u largua. Më pas e dërgoi atë të vendgjuatja e mesme." Atij iu shfaq sërish shejtani. Ibrahimi (Paqja qoftë mbi të!) e goditi atë sërish me shtatë guralecë dhe ai përsëri u largua. Pastaj e çoi te*

[32] Sahihu Buhari, Kitabul enbija, Babunn, jezifune en neselan fil meshij, vëll. 2, f. 158. Shih, "Mu'xhemul Bilad", fjala "Zemzeme". "Dhikru tarikhu Ismail" prej historisë së Tabarit dhe ibn Kethijrit.

vendgjuatja e vogël. Atij iu shfaq shejtani dhe Ibrahimi e goditi me shtatë guralecë e ai u largua."[33]

Kështu, Allahu e ka bërë gjuajtjen e shejtanit një prej riteve të Haxhit, në përkujtim të gjuajtjes së Ibrahimit *(Paqja qoftë mbi të!).*

d) Kurbani

Allahu i Madhëruar e ka mbajtur të gjallë kujtimin e flijimit të Ismailit, djalit të Ibrahimit *(Paqja qoftë mbi ta!),* me dërgimin e dashit, duke e bërë atë pjesë të riteve të Haxhit.

Ai i urdhëron Haxhinjtë të bëjnë kurban në Mina, në nder të Ibrahimit *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe si festë për bindjen e tij ndaj Allahut.

فَبَشَّرْنَٰهُ بِغُلَٰمٍ حَلِيمٍ ﴿١٠١﴾ فَلَمَّا بَلَغَ مَعَهُ ٱلسَّعْىَ قَالَ يَٰبُنَىَّ إِنِّىٓ أَرَىٰ فِى
ٱلْمَنَامِ أَنِّىٓ أَذْبَحُكَ فَٱنظُرْ مَاذَا تَرَىٰ ۚ قَالَ يَٰٓأَبَتِ ٱفْعَلْ مَا تُؤْمَرُ ۖ سَتَجِدُنِىٓ
إِن شَآءَ ٱللَّهُ مِنَ ٱلصَّٰبِرِينَ ﴿١٠٢﴾ فَلَمَّآ أَسْلَمَا وَتَلَّهُۥ لِلْجَبِينِ ﴿١٠٣﴾ وَنَٰدَيْنَٰهُ
أَن يَٰٓإِبْرَٰهِيمُ ﴿١٠٤﴾ قَدْ صَدَّقْتَ ٱلرُّءْيَآ ۚ إِنَّا كَذَٰلِكَ نَجْزِى ٱلْمُحْسِنِينَ ﴿١٠٥﴾
إِنَّ هَٰذَا لَهُوَ ٱلْبَلَٰٓؤُا۟ ٱلْمُبِينُ ﴿١٠٦﴾ وَفَدَيْنَٰهُ بِذِبْحٍ عَظِيمٍ ﴿١٠٧﴾

[33] "Musned Ahmed", 1: 306. Përafërsisht si ai në faqen 127. Musned et Tajalisij, Hadithi 2697. Shih në "Mu'xhemul buldn", Fjala "El Ka'betu" dhe shih gjithashtu "Historia e Ibrahimit dhe e Ismailit" në Tarikh Et Tabarij dhe ibn Ethijr.

"Dhe Ne i dhamë lajmin e gëzuar për një djalë të mbarë! Kur fëmija u rrit, aq sa ta ndihmonte në punë, Ibrahimi i tha: 'O djali im, kam parë ëndërr se duhet të të flijoj. Çfarë mendon ti?' – I biri i tha: 'O ati im, vepro ashtu siç je urdhëruar! Dashtë Allahu, unë do të jem i durueshëm!' Pasi iu nënshtruan që të dy urdhrit, (Ibrahimi) **e vuri** (Ismailin) **me ballë përtokë. Ne e thirrëm: 'O Ibrahim, ti e përmbushe ëndrrën.' Vërtet, Ne kështu i shpërblejmë punëmirët! Kjo, me të vërtetë ka qenë një sprovë e qartë! Dhe Ne e zëvendësuam atë** (Ismailin) **me një kurban të madh."** (Sure "Safat", ajetet 101-107).

Në vijim po përmendim përhapjen e bereqetit prej Ademit *(Paqja qoftë mbi të!),* babait të njerëzimit.

PËRHAPJA E BEREQETIT PREJ ADEMIT *(Paqja qoftë mbi të!)*

DHE FESTIMI NË PËRKUJTIM TË TIJ

Në disa lajme thuhet se Allahu i Madhëruar ia pranoi pendimin Ademit pasditen e datës së nëntë të muajit Dhil Hixheh, në Arafat. Pastaj, në perëndim të diellit, Xhebraili e dërgoi në Mesh'arin e Shenjtë. Aty qëndroi natën e dhjetë të muajit Dhul Hixheh, duke iu lutur Allahut të Madhëruar dhe duke e falënderuar për pranimin e pendimit.

Në mëngjesin e ditës së dhjetë e dërgoi në Mina dhe ia rruajti kokën, si shenjë e pranimit të pendimit dhe e lirimit të tij prej gjynahut. Atë ditë Allahu i Madhëruar e bëri festë për të dhe për pasardhësit e tij (Ademit). Çdo gjë, prej veprimeve që bëri Ademi, Allahu i Madhëruar e ka bërë pjesë të riteve të Haxhit për pasardhësit e tij. Allahu i Plotfuqishëm ua pranon pendimin, pasditen e ditës së nëntë në Arafat.

Ata e përmendin Allahun e Madhëruar natën në Mesh'arul Haram dhe rruajnë kokat e tyre në ditën e dhjetë në Mina. Këtyre riteve i është shtuar edhe veprimi i Ibrahimit, i Ismailit *(Paqja qoftë mbi ta!)* dhe i Haxhires. Pra, të gjitha veprat e Haxhit janë bereqet për ato vende dhe kohë ku jetuan njerëzit e mirë të Allahut. Të gjitha ato janë festë në shenjë të përmendjes së tyre gjatë gjithë kohëve.

Më poshtë po paraqesim disa shembuj të përhapjes së ndjellkeqjes.

Muslimi transmeton se i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në vitin e Tebukut i çoi njerëzit në Haxhr, te shtëpia e Themudit. Njerëzit pinë ujë nga të njëjtat puse që pinte edhe Themudi. Ata bënë brumë me atë ujë dhe përgatitën tenxheret me mish. I Dërguari i Allahut i urdhëroi njerëzit që ta djegin ushqimin e tenxhereve, brumin t'ua japin deveve. Pastaj u nis me ta, derisa arritën te pusi, ku do pinte ujë deveja. Ai i ndaloi ata të hynin te populli që u dënua. Ai u tha: "Unë frikësohem se do të goditeni njësoj si u goditën ata, prandaj mos hyni tek ata."[34]

Sipas thënies së Muslimit: "*'Mos hyni në vendbanimet e atyre që i bënë padrejtësi vetes së tyre, vetëm duke qenë duke qarë. Kujdes se mos goditeni edhe ju njësoj si u goditën ata.' Pastaj urdhëroi dhe shpejtoi, derisa e la pas atë."*

Sipas thënies së Buhariut: "*Pastaj mbuloi kokën e tij dhe shpejtoi ecjen, derisa e kaloi luginën."*

Në një transmetim tjetër, në Musnedin e Ahmedit: "*Ai u mbulua me rrobën e tij dhe kishte hipur mbi deve."*[35]

[34] E ka përcjellë Muslimi, me përmbledhje në Sahihun e tij, Kitabu Zuhd dhe rekaik, Kreu "Mos hyni në vendet e atyre që i bënë padrejtësi vetes së tyre". Hadithi 40. Shprehja e Musned Ahmed, 2:117. Sahihu Buhari, Kitab El Megazij, Kreu "Zbritja e Profetit në Haxhr".

[35]Musnedi i Ahmedit, 2: 66.

ZANAFILLA E NDJELLJAKEQES DHE E BEREQETIT TË NJË VENDI

Prej nga erdhi keqndjellja e vendbanimit të Themudit dhe si u përhapën puset e tij në të? Keqndjellja nisi nga populli i Themudit, u përhap prej tyre dhe puset qëndruan deri në kohën e vulës së profetëve dhe deri sa të dëshirojë Allahu i Madhëruar. Po ku e ka zanafillën mirësia e pusit të devesë së Salihut? (Përveç pirjes së devesë së Salihut prej tij, mirësia e të cilit qëndroi deri në kohën e vulës së profetëve dhe do të qëndrojë sa të dëshirojë Allahu i Madhëruar.)

Deveja e Salihut dhe pusi i saj nuk janë më të mirë te Allahu se sa Ismaili *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe uji Zemzem. Mirësitë e Zemzemit, Allahu i Plotfuqishëm i ka bërë pjesë të bereqeteve të Ismailit *(Paqja qoftë mbi të!)* përgjatë kohërave. Po ashtu, përhapja e mirësive të Allahut për robtë e Tij është në kohë të veçanta, siç është edhe dita e premte (xhuma).

BEREQETET E DITËS SË PREMTE *(xhuma)*

Në Sahihun e Muslimit thuhet: *"Vërtet, Allahu e krijoi Ademin ditën e premte (xhuma) dhe e futi atë në Xhenet po në këtë ditë…"*[36]

Të gjitha mirësitë që Allahu i Madhëruar u jep robëve të Tij punëmirë ditën e premte (xhuma), janë të përhershme.

[36] Sahihu i Muslimit, Kapitulli i xhumasë, Kreu "Mirësitë e xhumasë", Hadithi 17 dhe 18.

MIRËSITË E MUAJIT TË RAMAZANIT

Po ashtu, edhe mirësitë në Muajin e Ramazanit janë të shumta. Allahu i Madhëruar thotë: "**Muaji i Ramazanit është ai, në të cilin ka zbritur Kur'ani, që është udhërrëfyes për njerëzit, plot me shenja të qarta për rrugën e drejtë dhe dallues** (i së mirës nga e keqja)**…"**[37]

شَهْرُ رَمَضَانَ ٱلَّذِىٓ أُنزِلَ فِيهِ ٱلْقُرْءَانُ هُدًى لِّلنَّاسِ وَبَيِّنَٰتٍ مِّنَ ٱلْهُدَىٰ وَٱلْفُرْقَانِ ۚ ... ﴿١٨٥﴾

Dhe: **"Ne e kemi zbritur** (Kur'anin) **në Natën e Kadrit. E kush mund të ta shpjegojë ty se ç'është Nata e Kadrit? Nata e Kadrit është më e mirë se njëmijë muaj."**[38]

إِنَّآ أَنزَلْنَٰهُ فِى لَيْلَةِ ٱلْقَدْرِ ﴿١﴾ وَمَآ أَدْرَىٰكَ مَا لَيْلَةُ ٱلْقَدْرِ ﴿٢﴾ لَيْلَةُ ٱلْقَدْرِ خَيْرٌ مِّنْ أَلْفِ شَهْرٍ ﴿٣﴾

Një nga mirësitë e Natës së Kadrit është se Allahu i Madhëruar, në këtë natë të bekuar, i zbriti Profetit Muhamed *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* Kur'anin Famëlartë, si dhuratë për të gjithë njerëzimin.

---

[37] Sure "El-Bekare", ajeti 185.
[38] Sure "El-Kadr", ajetet 1-3.

Së fundi, krahas ceremonive në përkujtimin e të zgjedhurve të Allahut, vërtetojmë dhe dëshmojmë se qëllimi ynë me ceremonitë e përkujtimit të tyre është: Leximi i jetëshkrimit të saktë të Profetit Muhamed *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në natën e lindjes së tij, të ushqyerit në këto ceremoni për hir të Allahut të Madhëruar, dhurimi i shpërblimit të kësaj vepre të Dërguarit të Allahut dhe mosveprimi i veprave që i shpikën disa mistikë.

MUS'HAFI
TEK TRANSMETIMET

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Se ky është vërtet një Kur'an i nderuar; në Librin e ruajtur."[39]

إِنَّهُۥ لَقُرْءَانٌ كَرِيمٌ ﴿٧٧﴾ فِى كِتَٰبٍ مَّكْنُونٍ ﴿٧٨﴾

[39] Sure "El-Vakia", ajeti 77-78.

PLANET DHE LINJAT E KËRKIMIT STUDIMOR

Mus'hafi (Libri i madhërishëm):

1. Në kuptimin gjuhësor
2. Në terminologjinë e sahabëve
3. Në transmetimet e Ehli Bejtit *(Paqja qoftë mbi ta!)*
4. Në lajmet e shkollës së kalifave, mus'hafi i Halid bin Mi'danit
5. Njohja e mus'hafit me gjithçka që është shkruar dhe është bërë nga të dy faqet
6. Mus'hafi në terminologjinë e popujve të mëparshëm
7. Mus'hafi i Fatimes, vajzës së të Dërguarit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*
8. Mus'hafet e sahabëve
9. Mus'hafi i të Dërguarit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).*

Politika e zhveshjes dhe e mëvetësimit të mus'hafit, nga hadithi i të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).*

MUS'HAFI

1. Në kuptimin gjuhësor

Es-Sahijfetu - *fleta, pergamena* është ajo mbi të cilën mund të shkruhet. Shumësi i kësaj fjale është *sahaif* dhe *suhuf,* ndërsa *mus'haf* dhe *mis'haf*: *Grumbullimi e tubimi i këtyre letrave në një libër, ndërmjet dy kapakëve të tij*.[40]

Në lidhje me komentimin e fjalës *ed-dufetu* kanë thënë: "Është ana e gjithçkaje dhe faqja e saj. Dy anët e daulles janë dy lëkurat që e rrethojnë atë dhe që goditet mbi to." Nga ky kuptim vjen edhe dy anët e *mus'hafit*. Thuhet: E ka mësuar librin nga kapaku në kapak[41], pra, e ka memorizuar të gjithë librin.

Bazuar në ato që përmendëm, *mus'hafi është emri i një libri me kapak të trashë.*[42] Kjo për arsyen se, po të ishte fletushkë, mbi të cilën mund të shkruhet, shumësi i saj do të ishte suhuf, ndërsa *mus'hafi* është shumësi i *suhufeve– fletëve, dy faqet e saj*. Ndërsa *duffetane* janë *dy kapakët e librit*. Kështu që *mus'hafi*, në këtë rast, për ne, ka kuptimin e librit me kapak të trashë (me lidhje speciale).

---

[40] Kthehu tek Lënda "Suhuf", te fjalori "Es-Sihah", i El-Xhevherij (ka ndërruar jetë në vitin 393 hixhri). Fjalori "El-Muhkem", i Ibn Sejideh (ka ndërruar jetë në vitin 458 hixhri). "El-Mufredat", i Er-Ragib (ka ndërruar jetë në vitin 502 hixhri). "Lisanul-Arab", i Ibn Mendhurit (ka ndërruar jetë në vitin 711 hixhri). Fjalori "El-Muhijt", i Fejruz Abadij (ka ndërruar jetë në vitin 816 ose 817 hixhri).

[41] Kthehu te fjalori "Taxhul-Arus", i Ez-Zubejdij (ka ndërruar jetë në vitin 1205 hixhri), si dhe te fjalori "El-Vesijt", Lënda "Defefe".

[42] Në gjuhën e sotme njihet me termin: kapak me lidhje speciale (Sh. P.)

Kështu që: Mus'hafi është një emër që përdoret për çdo libër me kapak të trashë, qoftë ai Kur'an apo ndonjë libër tjetër.

2. Në terminologjinë e sahabëve

Termi *mus'haf*, në kuptimin gjuhësor, është përdorur në transmetimet e grumbullimit të Kur'anit, deri në kohën e Othmanit.

Buhariu transmeton nga Zejd ibn Thabit, se kalifi Ebu Bekër e urdhëroi atë me grumbullimin e Kur'anit. Zejdi ka thënë: "Unë fillova ta grumbulloj Kur'anin. Suhufet kanë qenë tek Ebu Bekri, deri sa ai ndërroi jetë. Më pas tek Omeri, e pastaj tek Hafsaja, vajza e Omerit."

Pas kësaj, transmetohet nga Enesi dhe përmbledhja e këtij transmetimi është: "Kur Othmani donte të grumbullonte (tubonte) Kur'anin, e dërgoi atë tek Hafsaja. Na i dërgoi suhufet, që t'i shtojmë (kopjojmë) në mus'hafe dhe pastaj t'i kthejmë ato tek ti…[43] Është e qartë se fjalët *suhuf* dhe *mesahif,* në të dy transmetimet e mësipërme, janë përmendur me të njëjtin kuptim gjuhësor, "Libër me kopertinë".

Një tjetër sqarim, më i madh se sa ai i Buhariut, është ai i ardhur nga Ibn Daud Es-Segjestani, tek libri i tij "El'-Mesahif", në kapitullin "Grumbullimi i Kur'anit në mus'hafe", ku transmeton nga:

[43] Sahijhul-Buharij, "Virtytet e Kur'anit", K. "Grumbullimi i Kur'anit", 3:150.

a- Muhamed bin Sijrijn ka thënë: "Kur Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, ndërroi jetë, Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)* u betua se do ta vishte rrobën e tij vetëm për xhuma, deri sa Kur'anin ta grumbullonte në mus'haf.

b- Ebi El-Alijeh ka thënë: "Ata e kanë grumbulluar Kur'anin në mus'haf gjatë udhëheqjes së Ebu Bekrit."

c- Husejni ka thënë: "Umer ibn El-Hatabi urdhëroi grumbullimin e Kur'anit dhe ai ka qenë i pari që e ka grumbulluar atë në mus'haf."[44]

I sollëm këto tre transmetime si dëshmi, sepse ato tregojnë se në kohën e transmetimit të tyre, mus'hafi, në thëniet e transmetuesve, ka qenë më përgjithësues se Kur'ani. Në ato transmetime është thënë:

a- Deri sa të grumbullojë Kur'anin në mus'haf.
b- E grumbulluan Kur'anin në mus'haf.
c- U urdhërua të grumbullojë Kur'anin dhe e grumbulloi.

Nëse fjala mus'haf tek ata do të ishte Kur'ani, atëherë komentimi i transmetimeve do të ishte si më poshtë vijon:

a- Deri sa të grumbullonte Kur'anin në Kur'an.
b- E grumbulluan Kur'anin në Kur'an.
c- Ishte i pari që e grumbulloi Kur'anin në Kur'an.

---

[44] Libri "El-Mesahif", i autorit El-Hafidh Ebij Beker Abdullah bin Ebij Daud Es-Sexhestani (i cili ndërroi jetë në vitin 316 hixhri, i korrektuar nga dr. Ether Xhefrij, Botimi i parë, Kajro, 1355 hixhri. Dy transmetimet *a* dhe *c* janë në f. 10, ndërsa *b* në f.9 të tij.

3. Në transmetimet e Imamëve të Ehli Bejtit *(Paqja qoftë mbi ta!)*

Mus'hafi, në transmetimet e Imamëve të Ehli Bejtit *(Paqja qoftë mbi ta!),* ka ardhur me të njëjtin kuptim gjuhësor si ai i shkollës së kalifave. Transmetohet nga El Kulijnij, tek kapitulli "Leximi i Kur'anit në mus'haf", në hadithin e parë nga Ebu Abdullah Xha'fer Es Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!),* i cili ka thënë: *"Ai që e lexon Kur'anin në mus'haf, kënaq shikimin e tij dhe lehtëson ndëshkimin e dy prindërve të tij, edhe nëse janë qafirë."*

Në hadithin e katërt të tij, gjithashtu, nga Ebi Abdilah, Es Sadik *(Paqja qoftë mbi të!),* lexojmë: *"Leximi i Kur'anit në mus'haf lehtëson ndëshkimin e dy prindërve, edhe sikur të kenë qenë jobesimtarë."*[45]

Bazuar në ato që përmendëm më sipër, vërtetohet plotësisht se kuptimi i fjalës *mus'haf*, që përdorej në fjalët e sahabëve, tabi'inëve, tek transmetuesit e shkollës së kalifave dhe tek transmetuesit e shkollës së Ehli Bejtit *(Paqja qoftë mbi ta!)* ishte për librin me kopertinë. Pra, në fillim të Islamit është përdorur fjala *mus'haf* në kuptimin e tij gjuhësor. Pastaj në shkollën e kalifave u bë i njohur emri Kur'an, i shkruar dhe i përhapur në formën e librit me dy kapakë.

[45] "Usulul Kafij", 2: 613, botuar në Teheran, viti 1388 hixhri.

4. Në transmetimet e shkollës së kalifave

Në shkollën e kalifave, përveç Kur'anit janë emërtuar me emrin mus'haf si vijojnë:

Mus'hafi i Halid ibn Mi'danit

Ibn Ebu Daud (ndërroi jetë në vitin 316 hixhri), Ibn Asakir (ndërroi jetë në vitin 571 hixhri), El Mezij (ndërroi jetë në vitin 742 hixhri), Ibn Haxher (ndërroi jetë në vitin 852 hixhri), për biografinë e Halid ibn Mi'danit, kanë thënë: "Dituria e Halid ibn Mi'danit për mus'hafin e tij ka qenë çelës, buton e komçë (pra, ka ditur gjithçka në lidhje me të).[46]

Kush është Halid bin Mi'dani, autori i mus'hafit?

Halid ibn Mi'dani ka qenë një prej dijetarëve më të mëdhenj të Shamit dhe nga tabi'inët. E kanë njohur shtatëdhjetë prej sahabëve. Biografinë e tij e ka shkruar Ibn El Ethijr (ndërroi jetë në vitin 630 hixhri), te lënda "El-Kelaij"[47] dhe ka thënë: "Halidi ndërroi jetë në vitin 103, 104, ose 108 hixhri."

---

[46]"El-Mesahif", 134-135. "Historia e Damaskut", dorëshkrim i Bibliotekës Dhahirije në Damask, Departamenti i Grupit Shkencor Islam, në Teheran 5/2/259A. "Tehdhijbul-Kemal", dorëshkrim i Bibliotekës Dhahirije në Damask, Departamenti i Grupit Shkencor Islam, në Teheran 2/ 170. "Tehdhijbut-Tehdhijb", 3: 118-119.

[47] "El-Lubab Fi Tehdhijbul-Ensab", 3: 62-63. Kthehu tek burimet e biografisë së tij, tek futnota me numër 8.

5. Njohja e mus'hafit me gjithçka që është shkruar dhe është vendosur mes dy kapakëve, me emrin *Libri me kapak*

Mus'hafi, libri me kapak, ka qenë shumë i njohur, qarkullonte tek dijetarët e studiuesit e shkollës së kalifave. Për këtë po marrim dy shembuj:

a. Anun ibn Ebu Daud Es Sexhestanij, një nga dijetarët e mëdhenj të shekullit të tretë hixhri, në librin e tij "El Mesahif", thotë:

1. "Ebu Bekr Es Sidijk *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)* e grumbulloi Kur'anin në mesahif, pas të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).*
2. Ali ibn Ebiu Talib *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)* e grumbulloi Kur'anin në mus'haf.
3. Umer ibn Hatabi *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)* e grumbulloi Kur'anin në mus'haf."[48]

Prej bashkëkohësve, Nasirud-Dijn El-Esed, në librin e tij "Esh Shi'rul Xhahilij", ka thënë: Librin e grumbulluar e quanin mus'haf dhe synonin librin në përgjithësi dhe jo vetëm Kur'anin. Pastaj lajmin e mus'hafit e transmetoi Halid ibn Mi'dan, nga libri "El-Mesahif", i autorit Ibn Ebu Daud Es Sexhestanij.[49]

[48] Libri "El-Mesahif": 5 dhe 10, sipas serisë së transmetimit.

[49] Burimet e poezisë para Islamit: 139, Botimi i pestë. Dhe e ka transmetuar atë Es-Sexhestanij, te "El-Mesahif", 134-135.

6. Termi *Mus'haf* në terminologjinë e popujve të mëparshëm

Emërtimi i librave fetarë te popujt e mëparshëm me emrin *mus'haf*

Gjithashtu, edhe librat e tjerë fetarë të popujve të mëparshëm janë quajtur *mus'haf*, siç ka ardhur te libri "Tabakat" i Ibn Sa'adit, me zinxhirin e tij të transmetimit, nga Sehl Meula Utejbe, i cili ka qenë i krishterë prej banorëve të Merijs. Ai u rrit jetim, nën kujdesin e nënës dhe të xhaxhait të tij dhe lexonte Ungjillin. Sehli ka thënë: "E mora mus'hafin nga xhaxhai im dhe e lexova atë, por hasa në një fletë, që nuk mund ta lexoja. E fërkova atë me dorën time, ndërkohë vura re se disa fletë ishin të ngjitura me zamkë. I ndava ato, lexova për cilësinë e Muhamedit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: "Ai nuk ishte as i gjatë dhe as i shkurtër, i bardhë, me dy gërsheta, ndërmjet dy shpatullave kishte një nishan, jepte shumë dhe nuk e pranonte sadakanë, hipte në gomar e deve, milte delet, vishte një këmishë me arna. Ai që e bën këtë është i shfajësuar nga mendjemadhësia. Ai e bënte një gjë të tillë. Ai është nga trashëgimtarët e pasardhësit e Ismailit. Emri i tij është Ahmed." Ndërkohë që po mbaroja leximin e cilësive të Muhamedit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, erdhi xhaxhai im dhe, kur e pa letrën, më qëlloi e më tha: "Kush të tha ta hapësh këtë faqe e ta lexosh atë?"

I thashë: "Në të ka një cilësi të Profetit Ahmed *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*."

Xhaxhai m'u përgjigj: "Ai nuk ka ardhur ende."[50]

Në këtë mënyrë ne gjetëm se mus'hafi është një emër i përgjithshëm për librat me dy kapakë. Nëse është e saktë ajo që ka ardhur në transmetimin e "El Mesahif" të Ibn Ebu Daud se Ebu Bekri e ka quajtur Kur'anin mus'haf, ky emërtim nuk ka qenë shumë i njohur deri në kohën e Othmanit, siç bëhet e qartë në dy hadithet e sakta të Buhariut, të përmendura më parë. Porse emërtimi i Kur'anit me mus'haf u bë i njohur pas kësaj. Gjithashtu, në atë kohë ky emërtim nuk mbeti i kufizuar me Kur'anin, sepse me emrin mus'haf u quajtën edhe libra të tjerë të shkollës së kalifave e të shkollës së Ehli Bejtit *(Paqja qoftë mbi ta!)*. Prej tyre ishte mus'hafi i Fatimes, vajzës së të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

7. **Mus'hafi i Fatimes** *(Paqja qoftë mbi të!)*, **vajzës së të Dërguarit të Allahut** *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*

Nga transmetime ka ardhur se Fatimja, vajza e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka pasur një libër që quhej *mus'haf,* në të cilin kishte lajme të fshehta.

Tek libri "Basairud-Derexhat" ka ardhur me më shumë se një zinxhir transmetimi se Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Ka pasur fise e popuj që vinin e

[50] "Tabakat ibn Sa'ad", 1: 363, Botim i Bejrutit.

pyesnin atë se çfarë i la Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, Aliut *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe çfarë i la Aliu Hasanit *(Paqja qoftë mbi ta!)*: "I Dërguari i Allahut na ka lënë neve çdo gjë të nevojshme, deri edhe llakosjen e flokëve apo manikyrin e thonjve. Fatimesë i ka lënë një mus'haf, që nuk është Kur'an…"[51]

Pra, vajza e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka pasur një mus'haf, ashtu siç ka pasur Halid ibn Mi'dani një libër, që emri i tij ishte mus'haf dhe përmbante diturinë e tij.

Imamët e Ehli Bejtit, të cilët e përhapën këtë lajm, kanë thënë me tekst se ai nuk është Kur'an dhe se në të nuk ka asgjë prej Kur'anit. Përkundrazi, ai ka lajme të ngjarjeve që do të ndodhin në të ardhmen.

Për fat të keq, disa shkrimtarë të shkollës së kalifave kanë shpifur e kanë thënë: *"Mus'hafi i Fatimesë, tek ndjekësit e shkollës së Ehli Bejtit është Kur'an tjetër."* Por ndjekësit e Ehli Bejtit nuk e kanë thënë një gjë të tillë për mus'hafin e Halidit dhe as për librin e Sibeuejhit.

8. **Mesahifus-Sahabe** (Librat e shokëve)

Shumë prej sahabëve kanë pasur mesahif, ku çdonjëri prej tyre ka shkruar në mus'hafin e tij, Kur'anin dhe atë që ka dëgjuar nga i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në

[51] "Basairud-Derexhat": 156. Transmetuam tematikën e nevojshme të hadithit. Për detaje të lajmit, kthehu te "Direktivat e dy shkollave", 2: 322.

lidhje me komentimin e disa prej ajeteve të Kur'anit. Pra, në këtë rast, kuptimi i mesahifeve të sahabëve, në kohën e tyre, ka qenë Kur'ani i shkruar, së bashku me hadithet e Profetit dhe me komentimin e disa ajeteve të tij, ashtu siç është rasti i librave të komentimit, si për shembull: "Ed Durrul Menthur Fi Tefsijril Kur'an", i autorit Es Sujutij, i shkollës së kalifave; libri "El Burhan Fi Tefsijril Kur'an", te ndjekësit e shkollës së Ehli Bejtit *(Paqja qoftë mbi ta!)*

Dy shembuj të Mesahifus Sahabe:

a- **Mus'hafi i nënës së besimtarëve, Aisheja**

Nga Ebu Junus, shërbyesi Meula i Aishes, transmetohet: "Aishja më urdhëroi mua që të shkruaj një mus'haf për të e tha: "Kur të arrish tek ky ajet: **"Mësohuni e bëjeni shprehi namazet dhe namazin e mesëm."**, më thuaj. Kur arrita tek ky ajet, e lajmërova atë.
Më pas më tha të shkruaj: "Bëjeni shprehi namazin dhe namazin e mesëm, namazin e ikindisë. Ngrihuni të frikësuar për Allahun."

Aishja tha: "E kam dëgjuar nga i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)."*

b- Mus'hafi i nënës së besimtarëve, Hafsa

Nga Ebu Rafiu, shërbëtori i Hafsasë, transmetohet: "Hafsaja më kërkoi mua që t'i shkruaj një mus'haf e më tha se, nëse mbërrij tek ky ajet, të shkoj te ajo, që të shkruaj diçka. Në momentin që mbërrita tek ky ajet: **"Bëjini**

shprehi namazet.", më tha: "Shkruaj: "Bëjini shprehi namazet dhe namazin e mesëm, namazin e ikindisë."[52]

Me lejen e Allahut të Lartësuar, në vijim, do të përmendim të tjerë mesahif.

9. **Mus'hafi i të Dërguarit të Allahut** *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*

Në kërkimin studimor të historisë së Kur'anit, në periudhën e Ebu Bekrit, do të lexojmë se i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka porositur e ka këshilluar Imam Aliun *(Paqja qoftë mbi të!)* që pas vdekjes së tij, të mos e veshë rrobën e tij, deri sa të grumbullojë suhufet (fletushka) që ishin në shtëpinë e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!),* në të cilat u shkrua Kur'ani me urdhër të të Dërguarit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* kishte urdhëruar Imam Aliun me shkrimin e çdo gjëje që kishin nevojë myslimanët, në lidhje me komentimin e ajeteve, që i kishte nxënë ato përmes rrugës së shpalljes.[53]

---

[52] Do t'i shpjegojmë me detaje lajmet e mesahifeve (librave) të sahabëve, me zinxhirët e transmetimit të tyre, nëse do Allahu i Lartësuar në broshurën e dytë të këtij libri, në kërkimin studimor, në lidhje me mosmarrëveshjes ndërmjet mesahifeve të sahabëve.

[53] Siç e faktuam në kërkimin studimor: "Kur'ani dhe Suneti janë dy burimet e legjislacionit të shkollës së Ehli Bejtit *(Paqja qoftë mbi ta!)*, të volumit të dytë të direktivave të dy shkollave."

Bazuar e mbështetur në ato që thamë më parë, mus'hafet kanë qenë në fillimet e Islamit, ashtu si kemi sot komentimet e Kur'anit, që përfshijnë Kur'anin dhe atë që ka sqaruar i Dërguari *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* në komentimin e ajeteve. Por pas të Dërguarit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* u zbatua politika e kalifave në zhveshjen dhe mëvetësimin e Kur'anit, nga hadithi i të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

POLITIKA E ZHVESHJES SË KUR'ANIT, NGA HADITHI I TË DËRGUARIT TË ALLAHUT *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*

Kanë zbritur ajete që qortojnë parinë kurejshe, të cilët e kundërshtuan Profetin *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dhe e luftuan atë. Disa ajete të tjera kanë zbritur për qortimin e fiseve të disa sahabëve prej kurejshëve, siç është thënia e Allahut të Lartësuar: **"...ashtu si dhe pemën e mallkuar në Kur'an..."**[54] Ky ajet ka zbritur për Beni Umeje apo individë prej sahabëve.

Apo thënia e Allahut të Lartësuar në suren "Tahrim": **"Nëse ju të dyja ktheheni të penduara tek Allahu, sepse vërtet që zemrat tuaja patën devijuar, Allahu do t'ju falë. Nëse ju të dyja bashkoheni kundër tij,** (dijeni se) **Allahu është Mbrojtësi i tij, Xhebraili dhe besimtarët e mirë. Veç kësaj, edhe engjëjt e mbështesin atë. Në qoftë se ai ju ndan, Zoti i tij mund t'ju zëvendësojë me gra më të mira se ju: myslimane, besimtare, të bindura, të kthyera tek Allahu me pendim, adhuruese** (të Allahut)**, agjëruese, të martuara më parë ose të virgjëra."**[55] që kanë zbritur për nënën e besimtarëve, Aishen dhe nënën e besimtareve, Hafsanë.

---

[54] Sure "Isra", ajeti 60.

[55] Sure "Et-Tahrim", ajetet 4- 5.

Apo ajeti: **"...O Familje e Profetit! Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t'ju pastrojë plotësisht."**[56], që ka zbritur për të Dërguarin *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, Aliun, Fatimen, Hasanin dhe Husejnin *(Paqja qoftë mbi ta!)*.

Këto e shumë të tjera kanë qenë në kundërshtim me qeverisjen e kalifave, të cilët dolën me sloganin "*Ne na mjafton Libri i Allahut*" dhe e zhveshën Kur'anin nga hadithet e Profetit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*.

Ebu Bekri e filloi punën me të. Ai urdhëroi shkrimin e një kopjeje të Kur'anit, të zhveshur nga hadithi i të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kjo vepër përfundoi në kohën e Omerit. Ky e filloi punën e tij me ndalimin e përhapjes së hadithit të të Dërguarit të Allahut.

Pas vdekjes së Omerit, lindi konflikti mes sahabëve, tabi'inëve, Beni Umejes dhe fanatikëve të Othmanit. Një grup sillnin hadithe nga Profeti, të cilët qortonin të afërmit e udhëheqjes. Te pala kundërshtare gjendeshin mus'hafe (libra), ku në to kishte sqarime të të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* rreth kundërshtimit të udhëheqjes.

Ndërkohë Othmani zbatoi moton "Zhvisheni Kur'anin nga hadithi i të Dërguarit (*Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!"*. Ai mori kopjen

[56] Sure "El-Ahzab", ajeti 33.

e mus'hafit të zhveshur nga hadithet e Profetit, që ndodhej te nëna e besimtarëve, Hafsaja dhe riprodhoi disa kopje prej saj dhe e shpërndau atë në vendet myslimane.

Ai grumbulloi mus'hafet e sahabëve, ku autorët e tyre kishin grumbulluar në to tekstin e Kur'anit dhe atë që kishin dëgjuar nga sqarimi i të Dërguarit të Allahut në lidhje me komentimin e ajeteve dhe i dogji të gjitha ato.

Pas kësaj, mus'hafi u bë një emër i përveçëm i Kur'anit, i zhveshur prej sqarimeve të të Dërguarit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Me kalimin e kohës, myslimanët, në shekujt pasardhës, nuk e dinin se në mus'hafet e sahabëve gjendeshin sqarime të të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!),* bashkë me tekstin e Kur'anit.

Por pas vitit njëqind e dyzet e tre (143) të hixhrit, El Mensur El Abbasij u kërkoi dijetarëve myslimanë shkrimin e diturive. Ai u kërkoi që të shkruajnë libra të posaçëm me dijet e Kur'anit të shoqëruar me sqarimin e ajeteve të tij, siç ishte në kohën e Profetit. Ky libër që përmbante ajetet e Kur'anit së bashku me sqarimin e tyre u quajt mus'haf.

EL-BEDA

Njësimi rreth tryezës së Librit dhe Sunetit

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

"Allahu fshin çfarë të dojë e ngulit çfarë të dojë (në këtë libër) **dhe tek Ai është Libri amëz."**[57]

Falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve. Falja dhe lutja qofshin mbi Muhamedin dhe familjen e tij të pastër dhe paqja qoftë mbi sahabët e Tij të shfajësuar e besnikë.

[57] Sure "Er-Ra'd", ajeti 39.

El-Beda në gjuhësi dhe në terminologji

El-Beda në gjuhësi

El-Beda, në gjuhësi, ka dy kuptime:

A- Beda el emru buduuen dhe bedaen- *U shfaq dhe u duk me qartësinë më të plotë.*

B- Beda lehu el emru kedha - *iu shfaq atij një mendim;* i lindi atij një mendim i ri,

El-Beda, në kuptimin terminologjik të dijetarëve të besimit islam:

Beda lil'lahi fi emrin bedaen – Atij iu shfaq në atë çështje çfarë ishte e fshehur për robtë.

Ka gabuar ai që mendon se qëllimi i shfaqjes së Allahut në një çështje ka kuptimin e shfaqjes së diçkaje tjetër, e ndryshme nga ajo që ishte para el beda-s – I Lartësuar është Allahu i Madhëruar.

El-Beda në Kur'anin e Shenjtë

a) Allahu i Lartësuar thotë:

"Jobesimtarët thonë: "Sikur t'i ishte dërguar atij një mrekulli nga Zoti i tij?..."[58]

Dhe: **"Jobesimtarët thonë: "Pse nuk i dërgohet atij** (Muhamedit) **një mrekulli nga Zoti i tij?..."**[59]

Pastaj i Lartësuari thotë:

"...Asnjë i dërguar nuk ka sjellë me vete asnjë mrekulli, përveçse me lejen e Allahut. Çdo periudhë e kohës ka librin e vet (ku është shënuar caku i saj)**. Allahu fshin çfarë të dojë e ngulit çfarë të dojë** (në këtë libër)**; dhe tek Ai është Libri amëz. Edhe nëse Ne të tregojmë ty nga dënimi që u kemi premtuar atyre apo ta marrim shpirtin më parë, detyra jote është të kumtosh Shpalljen, se llogaria është te Ne."**[60]

Shpjegimi i fjalëve:

1- Ajet: verset, argument, mrekulli, etj.

Kuptimi i fjalës *ajet*, në gjuhë, është: Shenjë e dukshme dhe e qartë, siç ka thënë poeti:

"Në çdo gjë për Të ka argument *** që vërteton se vërtet Ai është Një i Vetëm."

Ajete janë quajtur edhe mrekullitë e profetëve, sepse ato janë shenja të vërtetësisë së tyre dhe të fuqisë së Allahut, i cili ua bëri të mundur atyre këtë mrekulli, për shembull: bastuni i Musait, siç ka ardhur në ajetin 67 të

[58] Sure "Er-Rra'd", ajeti 7.
[59] Sure "Er-Rra'd", ajeti 27.
[60] Sure "Er-Rra'd", ajeti 38-40.

sures "Shu'ara": **"Pa dyshim, në këtë ka shenja treguese, por shumica e njerëzve nuk janë besimtarë."**[61] dhe deveja e Salihut, siç ka ardhur në ajetin 73 të sures "El A'raf": **"Ndërsa fisit Themud Ne i dërguam vëllanë e tyre, Salihun. Ai tha: 'O populli im! Adhuroni Allahun, ju nuk keni zot tjetër përveç Tij. Në të vërtetë, juve ju është dhënë një shenjë e qartë nga Zoti juaj: kjo deve e Allahut për ju është një mrekulli. Lëreni të kullosë në tokën e Allahut dhe mos i bëni ndonjë të keqe, se ju pret ndëshkimi i ashpër!'"**[62]

Gjithashtu, Kur'ani i ka quajtur ajete për llojet e dënimeve, të cilat Allahu i zbriti mbi popujt jobesimtarë, siç është thënia e Allahut të Lartësuar te surja "Shu'ara" për popullin e Nuhut: **"Kurse të tjerët që mbetën pas, i fundosëm. Njëmend, në këtë ka këshillë, por shumica e njerëzve nuk janë besimtarë."**[63]

Për popullin e Hudit thotë: **"Ata e quajtën gënjeshtar atë, andaj Ne i shkatërruam ata. Njëmend, në këtë ka këshillë, por shumica njerëzve nuk janë besimtarë."**[64]

Për popullin e Faraonit, në suren "El A'raf", lexojmë: **"Prandaj, Ne u dërguam atyre përmbytje, karkaleca, rriqra, bretkosa dhe gjak, si shenja të qarta, por ata madhështoheshin dhe ishin popull keqbërës."**[65]

2- Exhel -periudhë e caktuar kohore

Fjala *el exhel*: Periudha e diçkaje dhe koha që caktohet për fillimin e një çështjeje dhe përfundimin e saj.

---

[61] Sure "Shu'ara", ajeti 67.
[62] Sure "El-A'raf", ajeti 73.
[63] Sure "Shu'ara", ajeti 120-121.
[64] Sure "Shu'ara", ajeti 139.
[65] Sure "El A'raf", ajeti 133.

Thuhet: *xhae exhel'luhu:* i erdhi vdekja. *Darabtu lehu exhelen*: i dhashë atij kohë të caktuar për punën e tij.

3- Kitab

Për fjalën *kitab* ka shumë kuptime dhe se qëllimi i saj këtu është: Masa e shkruar ose e përcaktuar. Kështu që kuptimi i thënies "Likul-li Exhelin Kitab" është: Për kohën e ardhjes së të Dërguarit me një mrekulli në një kohë të caktuar e të shkruar.

4- Jemhu (fshin):

Në gjuhësi kuptimi i fjalës *mehahu* është: e fshiu, e shmangu, e largoi, e shkatërroi ose e zhduku gjurmën e tij, si për shembull tek thënia e Allahut të Lartësuar:

a) "Ne e larguam shenjen e natës dhe e bëmë ditën ndriçuese..."[66]

Ajeti i natës është nata dhe *mahui i saj* –ka kuptimin e *largimit* të natës.

b) "...Allahu e shkatërron të pavërtetën dhe e forcon të vërtetën me fjalët e Veta. Ai e di mirë ç'ka në zemrat e tyre."[67] Pra, i zhduk gjurmët e të pavërtetës.

[66] Sure "Isra", ajeti 12.

[67] Sure "Shu'ara", ajeti 24.

Komentimi i ajeteve:

Allahu i Lavdishëm dhe i Lartësuar na lajmëron në këto ajete se jobesimtarët kurejsh kërkuan nga i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!)* që t'u sjellë atyre një mrekulli. Këtë kërkesë të tyre Allahu e sqaron në thënien e Tij: "**Ata thonë: 'Ne nuk do të të besojmë** (o Muhamed)**, derisa të bësh, që të shpërthejë nga toka një gurrë uji për ne, ose, derisa të kesh një kopsht hurmash dhe rrushi, nëpër të cilin të rrjedhin lumenj, ose, derisa ta bësh qiellin të bjerë copa mbi ne, siç ke thënë ose, derisa të sjellësh Allahun dhe engjëjt para nesh.'"** [68]

Gjithashtu, thotë**: "...Asnjë i dërguar nuk ka sjellë me vete asnjë mrekulli, përveçse me lejen e Allahut. Çdo periudhë e kohës ka librin e vet** (ku është shënuar caku i saj)**."**[69]

Në ajetin pasardhës Allahu përjashton e thotë: **"Allahu fshin çfarë dëshiron."** nga ky libër dhe çfarë është shkruar në të, si: furnizim, periudhë e caktuar kohore, lumturi, pikëllim, etj. **"Dhe e bën të qëndrueshëm"** çfarë dëshiron, çfarë nuk ka qenë e shkruar në këtë libër **"dhe tek Ai është Libri amëz"**, pra: libri themeltar, i cili është *Leuhul Mahfudh*, në të cilin nuk ndryshon dhe as nuk tjetërsohet asgjë në të.

[68] Sure "Isra", ajeti 90-92.
[69] Sure "Er Rra'd", ajeti 38.

Bazuar mbi këtë, pas kësaj, Allahu thotë në ajetin 40 të sures "Er Rra'd": **"Edhe nëse Ne të tregojmë ty nga dënimi që u kemi premtuar atyre"** prej dënimeve në jetën tënde**, "apo ta marrim shpirtin më parë"** përpara kësaj**, "detyra jote është të kumtosh"** dhe vetëm kaq.

Tregues për atë që përmendëm janë transmetimet e Et Tabariut, El Kurtubiut dhe Ibn Kethirit në komentimin e ajetit, të cilët shkurtimisht kanë thënë: Kur Umer ibn Hatabi po bënte tavaf rreth shtëpisë, thoshte: *"O Allah i Plotpushtetshëm, nëse më ke shkruar mua prej të lumturve, atëherë më bëj të qëndrueshëm në të. Nëse më ke shkruar mua prej fatkeqëve dhe mëkatarëve, atëherë më fshi mua e më bëj të qëndrueshëm tek banorët e lumtur e të falur, sepse vërtet Ti fshin e bën të qëndrueshëm çfarë do dhe tek Ti është Libri i amzës."*

Transmetohet nga Ibn Mes'ud se Umer ibn Hatabi thoshte: *"O Allah i Plotpushtetshëm, nëse më ke shkruar mua prej të lumturve, atëherë më bëj të qëndrueshëm në to dhe, nëse më ke shkruar mua prej të pikëlluarve, atëherë më fshi mua prej fatkeqëve e më bëj të qëndrueshëm tek banorët e lumtur, sepse vërtet Ti fshin e bën të qëndrueshëm çfarë do dhe tek Ti është Libri i amzës."*

Transmetohet nga Ebu Uail se Umer ibn Hatabi shpeshherë lutej: *"O Allah i Plotpushtetshëm, nëse na ke shkruar ne prej fatkeqëve, atëherë na fshi dhe na shkruaj prej të lumturve, sepse vërtet Ti fshin e bën të qëndrueshëm çfarë do dhe tek ti është Libri i amzës."*[70]

[70] Të tre hadithet i ka përcjellë Et Tabarij në komentimin e ajetit. Ebu Uail Shefijk ibn Selmetu El Esedij El Kufij ka thënë për biografinë e tij te libri "Tehdhijbut Tehdhijb" se është i besueshëm. Ka jetuar në kohën

Në librin "El Bihar" lexojmë: *"Nëse jam prej fatkeqëve, më fshi mua prej tyre dhe më shkruaj tek të lumturit, sepse Ti ke thënë në librin Tënd, të zbritur mbi Profetin Tënd (Paqja dhe bekimet e Tua qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*: **"Allahu fshin çfarë të dojë e ngulit çfarë të dojë** (në këtë libër) **dhe tek Ai është Libri amëz."**[71]

Kurtubiu, gjithashtu, argumenton këtë komentim me atë që transmeton nga dy Sahihat, Buhariut dhe Muslimit, se i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!)* ka thënë: *"Atë që e gëzon shtimi i furnizimit të tij e të harrohet për të gjurma e tij, exheli i tij, atëherë le të mbajë lidhjet me të afërmit e tij."*

Në një transmetim tjetër thuhet: *"Ai që dëshiron që Allahu t'i zgjasë moshën e tij dhe t'ia shtojë furnizimin e tij, atëherë le ta ketë frikë Allahun dhe të mbajë lidhjet me të afërmit e tij."*[72]

Transmetohet se, kur Ibn Abasi pyetej: "Si shtohet në moshë dhe në exhel?", ai përgjigjej: Allahu i Lartësuar ka thënë: **"Ai ju krijoi juve prej baltës së ngjizur, pastaj e bëri të kryer exhelin. Por edhe një exhel të emëruar tek Ai."** Exheli i parë është exheli i robit prej kohës së lindjes së tij e deri në kohën e vdekjes së tij. Exheli i dytë është prej kohës së ndërrimit jetë të tij deri në ditën që e takon atë në

---

e sahabëve e të tabi'inëve. Ka vdekur në kohën e hilafetit të Umer ibn Abdul Azijz dhe ishte njëqind vjeç. Nga ai kanë transmetuar të gjithë autorët e Sihaheve dhe Sunen, 10: 354.

[71] "El Bihar", 98: 162.

[72] *Sahih El Buharij*, 3: 34, Libri i edukatës, Kapitulli 12 dhe 13. Sahih Muslim: 1982, Hadithi 20 dhe 21, nga Kapitulli i lidhjes me të afërmit. Musned Ahmed 3:156, 247, 266 dhe 5: 76.

Barzakh, të cilin nuk e di askush përveç Allahut. Nëse robi e ka frikë Zotin e tij dhe mban lidhjet me të afërmit e vet, Allahu ia shton atij moshën në këtë jetë sa të dojë. Nëse mëkaton dhe shkëput marrëdhëniet me të afërmit, Allahu ia pakëson moshën në këtë jetë sa të dojë...hadithi.[73]

Ibn Kethiri ka shtuar mbi këtë argument, përmbledhja e së cilës është: "Ndoshta kësaj thënieje i përshtatet ajo që kanë transmetuar Ahmedi, En Nisaij, Ibn Maxheh nga Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!)*: "Vërtet njeriut i ndalohet furnizimi me mëkatin që kryen. Kaderin e kthen duaja dhe bamirësia e shton moshën."[74]

Në një hadith tjetër transmetohet: "Vërtet duaja dhe kaderi takohen ndërmjet qiellit dhe tokës."[75]

Kjo që përmendëm deri tani është vetëm një pjesë e atyre që janë përmendur në komentimin e këtij ajeti. Kanë përmendur edhe anë të tjera në komentimin e këtij ajeti, siç është thënia e tyre: "Qëllimi është fshirja e një rregulli dhe konstatimi i një tjetri." Pra, abrogimi i rregullave. E mira në këtë thënie është se ajeti i përfshin të gjithë. Kjo është ajo që ka zgjedhur Kurtubiu, i cili gjithashtu ka thënë: *"Ajeti është përgjithësues për të gjitha gjërat. Kjo është më e dukshme. Allahu e di më së miri."*[76]

---

[73] Tefsijr "El Kurtubij", 9:329-331.

[74] Transmetimi është në Synen Ibn Maxheh, Hyrja, Kapitulli 10, Hadithi 90.

[75] Tefsir "Ibn Kethir", 2: 519.

[76] Tefsir "El-Kurtubij", 9: 329.

Et Tabarij, Es Sujutij kanë transmetuar nga Ibn Abasi, në lidhje me thënien e Allahut të Lartësuar: **"Allahu fshin çfarë të dojë e ngulit çfarë të dojë** (në këtë libër) **dhe tek Ai është Libri amëz**.": "Në Natën e Kadrit Allahu përcakton çështjet e vitit, me përjashtim të lumturisë e të mjerimit."[77]

Për thënien **"Allahu fshin çfarë të dojë e ngulit çfarë të dojë** (në këtë libër)", Ibn Abasi ka thënë: "Prej dy librave Allahu fshin tek njëri dhe ngulit tek tjetri. **"dhe tek Ai është Libri amëz"**, pra, mbartësit e Librit."[78]

B) Në suren "Junus", Allahu i Lartësuar, ka thënë: **"Përse nuk pati ndonjë qytet, banorët e të cilit të besonin e t'u bënte dobi besimi i tyre, përveç popullit të Junusit? Kur ata besuan, Ne ua larguam dënimin e poshtërimit në jetën e kësaj bote dhe i lamë të kënaqeshin edhe njëfarë kohe."[79]**

Shpjegimi i fjalëve:

1- Keshefna

Thënia "keshefna anhu el gam", do të thotë: *zbuluam prej tij dënimin, pra, ia larguam atij*. Dhe "keshefe el adhabe", *zbuloi dënimin*, ia largoi dhe ia shmangu atë atij.

[77] Tefsir "Et-Tabarij", 13: 111 dhe Es-Sujuti me termin e "Et Tabarij".
[78] Tefsir "Sujuti",4: 65 nga Ibn Xherijr Et Tabarij. El Hakim ka thënë: "E saktësoi atë".
[79] Sure "Junus", ajeti 98.

2- El-Khizju

Khazije Khizjen, e poshtëroi dhe e skandalizoi.

3- Hijn

Fjala "el hijn", do të thotë koha dhe periudha kohore e papërcaktuar, në kuptimin e saj me pak apo shumë.

Komentimi i ajetit:

Tregimi i Junusit, në mënyrë të përmbledhur, ashtu siç ka ardhur në komentimin e ajetit nga Et Tabarij, El Kurtubij dhe Mexhmaul Bejan[80]: "Populli i Junusit ka qenë në tokën e El Musel në Nejneva. Ata adhuronin putat (idhujt). Allahu i Lartësuar u dërgoi atyre Junusin *(Paqja qoftë mbi të!),* që t'i thërrasë në Islam dhe t'i lënë ato që kanë adhuruar deri tani. Por ata refuzuan dhe ndoqën një (shejkh) prej dijetarëve të tyre.

Adhuruesi i thoshte Junusit *(Paqja qoftë mbi të!)* që të lutej për to. Ndërsa dijetari e ndalonte këtë gjë, duke i thënë atij: "Mos u lut për to, sepse vërtet Allahu do të të përgjigjet ty dhe nuk dëshiron shkatërrimin e robërve të Tij. Junusi *(Paqja qoftë mbi të!)* e pranoi thënien e adhuruesit.

Allahu i Lartësuar e lajmëroi Junusin *(Paqja qoftë mbi të!)* se atyre do t'u vijë ndëshkimi në filan muaj e në filan ditë. Ndërkohë Junusi *(Paqja qoftë mbi të!)* i lajmëroi për këtë dhe, kur u afrua koha, Junusi *(Paqja qoftë mbi të!)* doli përpara tyre me adhuruesin dhe dijetari mbeti me ta.

Populli i tij i tha: "Junusi *(Paqja qoftë mbi të!)* nuk na ka gënjyer. Vini re, nëse qëndron me ju këtë natë, atëherë nuk ka asgjë dhe, nëse nuk qëndron, dijeni mirë se do të

[80] "Mexhmaul Bejan", 3: 135. "El Kurtubij", 8: 384. "Et Tabarij", 11: 118. "Ed Durrul Menthur", 3: 317.

gdhiheni të ndëshkuar. Në mes të natës, Junusi *(Paqja qoftë mbi të!)* doli nga mesi i tyre. Kur e morën vesh këtë dhe panë gjurmët e ndëshkimit dhe u siguruan për shkatërrimin, vajtën tek dijetari.

Ky i fundit u tha atyre: "Frikësohuni Allahut, sepse Ai ju mëshiron ju dhe e kthen dënimin prej jush."Dilni në shkretëtirë dhe ndajini gratë prej fëmijëve dhe kafshët prej këlyshëve të tyre. Pastaj qani dhe lutuni. Ata vepruan. Dolën në shkretëtirë me gratë, fëmijët e kafshët e tyre. Veshën Musuh (rroba të prodhuara prej lëkurës së bagëtive).

Ata shfaqën besimin dhe pendimin me qëllim të pastër, duke ndarë prej çdo nëne fëmijën e saj tek njerëzit e bagëtitë. Disa i këputi malli për disa të tjerë. Ndryshoi zëri i tyre, u përzje zëri i tyre me të atyre dhe iu nënshtruan me përkushtim Allahut të Lavdishëm e të Lartësuar e thanë: "Besuam me atë që erdhi Junusi."

Zoti i tyre i mëshiroi ata, duke iu përgjigjur lutjes së tyre dhe ia largoi atyre dënimin. Pasi pendimi i tyre arriti tek Allahu, padrejtësitë ndërmjet tyre kthyen, saqë, nëse dikush do të vinte me një gur që e kishte marrë, do ta çonte në bazë e do ta kthente në vendin e tij. Kështu pra, Allahu ia fshiu dënimin popullit të Junusit *(Paqja qoftë mbi të!)*, pasi ata u penduan. Allahu fshin çfarë të dojë e ngulit çfarë të dojë dhe tek Ai është Libri amëz."

C –Në suren "El A'raf", Allahu i Lartësuar thotë: **"Ne i premtuam Musait se do t'i flisnim pas tridhjetë netësh, të cilat ia shtuam edhe me dhjetë të tjera, kështu që takimi me Zotin e tij u bë pas dyzet netësh. Musai i**

tha vëllait të vet, Harunit: "Më zëvendëso te populli im, mbaj rregull dhe mos ndiq rrugën e ngatërrestarëve!"[81]

Në suren "El Bekare" thotë: **"Kujtoni kur i caktuam Musait dyzet net** (për takimin me të)**, e pastaj ju adhuruat viçin, duke vepruar si keqbërës!"**[82]

[81] Sure "El A'raf", ajeti 142.
[82] Sure "El Bekare", ajeti 51.

El-Beda, në transmetimet e Shkollës së kalifave

Transmetohet nga Et Tajalisij, Ahmed, Ibn Sa'ad, Et Tirmijdhi, se termi është i Et-Tajalisij dhe është i përmbledhur: "I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!)* ka thënë: "Allahu i tregoi Ademit pasardhësit e tij. Ndërkohë pa një burrë të pashëm që nuri i tij shndriste."

Ademi tha: "O Zot im, kush është ky?"

Tha: "Ky është biri yt, Daudi!"

Ademi i tha: "O Zot im, sa është mosha e tij?"

Tha: "Gjashtëdhjetë vjeç!"

Ademi i tha: "O Zot im, shtoja moshën atij!"

Tha: "Jo, veçse po t'ia shtosh ti prej moshës tënde!"

Ademi i tha: "E sa është mosha ime?"

Tha: "Njëmijë vjeç!"

Ademi tha: "Sapo i kam dhuruar atij dyzet vjet prej moshës sime."

… Në momentin që i erdhi vdekja dhe i erdhën atij melekët tha: "Më ka mbetur nga mosha ime edhe dyzet vjet."

Thanë: "Vërtet ti ia ke dhuruar ato Daudit …"[83]

[83] "Et Tajalisij", 350, Hadithi 2692. *Musned Ahmed*, 1: 251, 298 dhe 371. *Tabakat* i Ibn Sa'ad, 1: 7-9, Shtëpia botuese "Europa". *SunenTirmijdhij*, 11: 196-197, në komentimin e sures "El A'raf". Dhe te libri "El Bihar", 4: 102-103 nga Imam Bakir *(Paqja qoftë mbi të!)* me një ndryshim të vogël në term.

Ky transmetim, duke i shtuar edhe transmetimet e mëparshme, që lajmërojnë lidhjen me të afërmit dhe homologët e saj të Shkollës së kalifave janë dëshmi se Allahu fshin çfarë të dojë e ngulit çfarë të dojë (në këtë libër) dhe tek Ai është Libri amëz.

Imamët e Ehli Bejtit *(Paqja qoftë mbi ta!)* e kanë quajtur fshirjen dhe ngulitjen El-Beda, ashtu siç do ta mësojmë në vijim.

El-Beda, në transmetimin e imamëve të Ehli Bejtit *(Paqja qoftë mbi to!)*

Në librin "El Bihar", transmetohet nga Ebu Abdilah, Imam Sadik *(Paqja qoftë mbi të!),* i cili ka thënë: "Allahu i Lavdishëm dhe i Lartësuar nuk ka dërguar ndonjë Profet deri sa të marrë prej tyre tre virtyte: Dëshminë e sundimit, shmangien e ortakërisë dhe se Allahu afron çfarë do dhe largon çfarë do."[84]

Në një transmetim tjetër, Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)* e përshkruan këtë çështje me fshirje dhe ngulitje: "Allahu i Lavdishëm dhe i Lartësuar nuk ka dërguar ndonjë Profet deri sa të marrë prej tyre tre virtyte: Dëshminë e sundimit, shmangien e ortakërisë dhe se Allahu afron çfarë do dhe largon çfarë do."[85]

Në një transmetim të tretë e ka quajtur fshirjen dhe ngulitjen me "El-Beda", ku shkurtimisht po përmendim: "Nuk ka ardhur Profet deri sa pohoi ndaj Allahut të Lartësuar El-beda." Hadith[86]

Imam Riza *(Paqja qoftë mbi të!)* ka thënë: "Nuk është dërguar asnjë Profet veçse me ndalimin e alkoolit dhe miratimin El-Beda ndaj Tij."[87]

---

[84] "El-Bihar", 4: 108, marrë nga Teuhijd Es Saduk.
[85] "El-Bihar", 4: 108. Marrë nga Teuhijd Es Saduk.
[86] "El-Bihar", 4: 108. Marrë nga Teuhijd Es Saduk.
[87] I njëjti burim.

Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi të!)*, në një transmetim tjetër, lajmëron për kohën e fshirjes dhe të ngulitjes, duke thënë: "Kur vjen Nata e Kadrit, zbresin engjëjt, shpirti i shenjtë dhe shkruesit në qiellin e kësaj bote dhe shkruajnë çfarë do të jetë prej kadasë caktimi) së Allahut për atë vit. Kështu që, nëse Allahu dëshiron të paraprijë diçka, apo të vonojë diçka, apo të pakësojë diçka, urdhëron melekun që të fshijë çfarëdo e më pas e ngulit atë që dëshiron."[88]

Gjithashtu, Imam Bakiri *(Paqja qoftë mbi të!)* shkurtimisht ka thënë: "Engjëjt dhe shkruesit zbresin në qiellin e kësaj bote dhe shkruajnë atë që do të jetë ekzistente në lidhje me çështjet e vitit dhe se çfarë do t'u ndodhë njerëzve në të." Ka thënë: "Çështja qëndron vetëm për Allahun e Lartësuar. Në Të është ecuria e çështjeve, paraprin çdo gjë dhe vonon çdo gjë. Kjo përputhet me thënien e Allahut të Lartësuar: **"Allahu fshin çfarë të dojë e ngulit çfarë të dojë** (në këtë libër) **dhe tek Ai është Libri amëz."**[89]

Në një hadith tjetër të tij, në lidhje me thënien e Allahut, ka thënë: **"Dhe nuk ia shtyn Allahu, një qenieje, nëse asaj i vjen exheli."**: "Vërtet tek Allahu ka libra të periudhave kohore, që paraprin prej tyre çfarë do dhe shtyn çfarë do. Në Natën e Kadrit, Allahu zbret në të çdo gjë, deri në një natë tjetër si ajo. Kjo është thënia e Allahut: **"Dhe nuk ia shtyn Allahu, një qenieje, nëse asaj i vjen**

[88] "El-Bihar", 4: 99. Komentimi i Ali ibn Ibrahim.
[89] "El-Bihar", 4: 102. Marrë nga Amali, i Esh Shejkh El Mufijd.

exheli." E shkruajnë atë shkrues të qiejve. Ai nuk e shtyn dhe nuk e vonon atë."[90]

El Mexhlisij, në këtë kapitull, transmeton lajmin e dhurimit të Ademit *(Paqja qoftë mbi të!),* dyzet vite, prej moshës së tij, Daudit, të cilin sapo e transmetuam në transmetimet e Shkollës së Kalifave.[91]

Kjo është El-Beda në lajmet e imamëve të Ehli Bejtit *(Paqja qoftë mbi ta!)*

Kurse "El-Beda" me kuptimin se Allahu u shfaq një mendim në lidhje me një çështje që nuk ka qenë në dijeni për të (Allahu na ruajtë e na mbroftë), transmetohet nga El Mexhlisij se Imam Sadiku *(Paqja qoftë mbi ta!),* kanë thënë: "Kush pretendon se Allahut të Lavdishëm dhe të Lartësuar i shfaqet diçka për të cilën nuk ka patur dituri më parë, atëherë shfajësohuni prej tij."[92]

[90] "El-Bihar", 4: 102. Marrë nga komentimi i Ali ibn Ibrahim.
[91] I njëjti burim. Marrë nga Ilelush-Sheraiu.
[92] "El Bihar", 4: 111. Marrë nga Ikmalu Dijn.

Ndikimi i bindjes me El-Beda

Nëse një njeri beson se ka njerëz që janë shkruar me të lumturit dhe se gjendja e tyre nuk ndryshon kurrë dhe nuk shkruhen me fatkeqët dhe të ligëtit, ashtu si ka prej tyre që janë shkruar prej fatkeqëve dhe të ligjve dhe se gjendja e tyre nuk ndryshon kurrë dhe nuk shkruhen tek të lumturit, e penda mbi të cilën ecën çdo njeri, thahet, në këtë rast, mëkatari nuk pendohet për mëkatin e tij, madje vazhdon në atë rrugë, si rezultat i bindjes së tij se kështu është shkruar për të dhe nuk ndryshon gjendja e tij.

Mundet që shejtani ta cytë robin e mirë se ai është prej të lumturve dhe se nuk shkruhet prej fatkeqëve dhe kjo cytje e çon në neglizhim ndaj përuljes dhe adhurimit.

Vihet re një mospërthitje e kuptimeve të ajeteve dhe transmetimeve të përmendura, nga disa myslimanë, në lidhje me ecurinë legjitime qiellore. Disa të tjerë, kanë bindjen se njeriu është i detyruar në atë që rrjedh prej tij. Pjesa tjetër thotë se e gjithë çështja i dedikohet njeriut. Këtë, me lejen e Allahut të Lartësuar, do ta mësojmë në një studim tjetër, në mënyrë që të njihemi me të drejtën.

SAHABI DHE DREJTËSIA E TIJ

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka thënë për dëshmorët e Luftës së Uhudit: "Unë do të dëshmoj për ata."

Ebu Bekri e pyeti: "A nuk jemi ne, o i Dërguari i Allahut, vëllezërit e tyre? E kemi pranuar Islamin, ashtu siç e kanë pranuar ata dhe kemi luftuar ashtu siç kanë luftuar ata." I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* iu përgjigj: "Natyrisht që po. Por nuk e di mirë se çfarë do të sajoni pas meje."[93]

93 "El Meute", 2: 462, hadithi 32, Kreu "*Xhihadi*".

Përkufizimi (njohja) e *sahabit* tek dy shkollat

1- Njohja e *sahabit* në shkollën e kalifave

Ibn Haxheri, te hyrja e librit të tij "El Isabe", kapitulli i parë, për përkufizimin e termit *sahab,* ka thënë: "Es Sahabij është ai që e ka takuar Profetin *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, është besimtar ndaj tij dhe ka vdekur në Islam. Sahab quhet ai që e ka takuar, ka kuvenduar gjatë apo shkurt me të, ai që ka transmetuar apo nuk ka transmetuar prej tij, ai që ka luftuar apo nuk ka luftuar me të; ai që e ka parë me sy dhe nuk ka kuvenduar me të, si dhe ai që nuk e ka parë atë për arsye të një aksidenti, si për shembull i verbëri."[94]

Tek vepra "Kriteri që përfitohet nga njohja e një grupi të madh sahabësh" ka thënë: "Vërtet, në vendet e çliruara nuk emëroheshin të tjerë përveç sahabëve.

Në vitin dhjetë hixhri, në Mekë dhe në Taif, nuk mbeti njeri që nuk e pranoi Islamin dhe që nuk dëshmoi me Profetin Haxhin e Lamtumirës.

Nuk mbeti njeri në Eus dhe Hazrexh, në fund të jetës së Profetit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!),* që nuk hyri në Islam.

[94] "El Isabetu", 1: 10.

Deri sa vdiq Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* asnjë prej tyre nuk e shfaqi mosbesimin."[95]

Nëse studiuesi i kthehet pjesëve të librit tonë "Njëqind e pesëdhjetë sahabë të sajuar", do të shohë tolerancën e tyre dhe dëmin e madh të këtij numri që i ka shkaktuar hadithit.

2- Përkufizimi i termit *sahab* te shkolla e Ehli Bejtit *(Paqja qoftë mbi të!)*

Es Sahib: shumësi i tij është: suhub, as'habë, suhab, sahabeh.[96]

Es Sahib është bashkëjetuesi[97], bashkëshoqëruesi.[98] Me këtë emër i thuhet atij që e shton bashkëshoqërimin[99] dhe se bashkëshoqëria kërkon qëndrimin e gjatë me të.[100]

Përderisa shoqërimi është midis dy vetave, për ne bëhet e qartë se patjetër duhet të shtohet termi *sahib* dhe shumësi i tij *suhub*, tek një emër gjatë bisedës.

Allahu i Lartësuar në Kur'an thotë: **"O dy bashkëkohësit e mi të burgut."** dhe **"As'habu Musa."**

Në kohën e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* thuhej: "Sahib

[95] I njëjti burim: 16.
[96] Kthehu te fjalori "Lisanul Arab", Lënda "Suhub".
[97] Kthehu te fjalori "Lisanul Arab", Lënda "Suhub".
[98] "Mufredatu Ragib", Lënda "Suhub".
[99] "Mufredatu Ragib", Lënda "Suhub".
[100] "Mufredatu Ragib", Lënda "Suhub".

(shoku) i të Dërguarit të Allahut" dhe "As'habët (shokët) e të Dërguarit të Allahut". Pra, fjala *sahib* apo *as'hab*, i shtoheshin fjalës *resulullah*. Gjithashtu, është thënë: "As'habët e Besëlidhjes së Pemës" dhe "As'habus-Sifeh".

Termat *sahib* dhe *as'hab'*, në atë kohë, nuk kanë qenë emra të posaçëm për as'habët e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Por, myslimanët, as'habët e shkollës së hilafetit, në mënyrë graduale, i quajtën as'habët e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, *sahabij* dhe *as'habë*. Bazuar në këtë, ky lloj emërtimi është emërtim nga myslimanët dhe i legjitimuar prej tyre. Ky ishte mendimi i dy shkollave në përkufizimin e termit *sahab*.

3- Kriteri i tyre për njohjen e sahabit dhe diskutimi i tij

Përveç atyre që përmendëm, biografët e sahabëve të Shkollës së kalifave kanë njohur rregulla të sakta për njohjen e sahabit. Ibn Haxheri, në librin "El Isabe", thotë: "Ajo që është përcjellë nga imamët prej thënieve përgjithësuese, për cilësitë me të cilat njihet të qenët e një burri sahab, edhe pse nuk është transmetuar me tekst një gjë e tillë, siç e transmeton Ibn Ebu Shejbe, në "Musanefin" e tij, me një metodikë të kënaqshme, se ata, në vendet e çliruara nuk emëroheshin veçse *sahabeh*."[101]

[101] "El Isabetu", 1:13.

Transmetimi që ka ardhur me një metodikë të pëlqyeshme është ai që e ka transmetuar Et Tabarij, Ibn Asakir, me zinxhir transmetimi, nga Sejf, nga Ebu Othman, nga Halid dhe nga Ubade: "Prijësit kanë qenë prej sahabëve, sepse nuk gjenin dikë që ta merrte një përgjegjësi të tillë."[102]

Në një transmetim tjetër, tek Et Tabarij, nga Sejfi, lexojmë: "Kalifi Umer nuk ka qenë i drejtë në emërimin e sahabëve për prijësi, nëse gjente prej tyre atë që i mjaftonte atij në luftën e tij. Dhe, nëse nuk gjente, emëronte më të mirin e tabi'inëve. Nuk lakmonte atë që shfaqej te transmetuesit për udhëheqësinë...[103]

4- Diskutimi i rregullit të njohjes së sahabit

Burimi i dy transmetimeve të lartpërmendur është Sejfi, i akuzuar për falsifikim dhe ateizëm.[104] Sejfi e transmeton rregullin (kriterin) nga Ebu Othmani, ndërsa Ebu Othmani, i cili ka transmetuar nga Halidi dhe Ubadeh, te transmetimet e Sejfit, atë e pandeh Sejfi. Jezijd ibn Usejd El Gassanij ka thënë: "Ky emër është nga sajesat e Sejfit në lidhje me transmetuesit."[105]

---

[102] "Et-Tabarij", 1: 2151, Shtëpia botuese "Europa".
[103] "Et-Tabarij", 1: 2457–2458.
[104] Kthehu Biografisë së Sejfit, në fillim të pjesës së parë të librit të Abdullah Ibn Sebe.
[105] Kthehu dorëshkrimit "Transmetuesit e sajuar" dhe librit të Abdullah ibn Sebe, 1: 117, botim i Bejrutit, 1403H.

Pavarësisht transmetimeve të ardhura dhe personave që i kanë transmetuar, realiteti historik e hedh poshtë atë që ata kanë përmendur.

Autori i librit "El Eganij" ka thënë: "I'mriul Kajs e pranoi Islamin në prani të Umerit dhe e bëri mëkëmbës para se të falte qoftë edhe një rekat të vetëm për Allahun."[106]

Lajmi i detajuar ndodhet te transmetimi pas atij që u përmend, i transmetuar nga Auf ibn Harixhe El Merij, i cili ka thënë: "Betohem në Allah! Unë isha te Umer ibn Hatabi *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)* në kohën e udhëheqjes së tij dhe erdhi një burrë i shëndoshë, me këmbë të hapura, me flokë të rruara anash e me pak flokë sipër,[107] që merrte në dorë drejtimin e njerëzve dhe, kur erdhi para Umerit, e përshëndeti atë me përshëndetjen e hilafetit.

Umeri i tha: "Kush je ti?"
Burri tha: "Unë jam I'mriu Nasranij (i krishterë). Unë jam I'mriul Kajs ibn Udej El Kelbiji."
Ndërkohë Umeri e njohu atë dhe i tha. "Çfarë dëshiron?"
Ai tha: "Islamin."

Umeri ia prezantoi Islamin dhe ai e pranoi atë. Pastaj ftoi që atij t'i jepnin një shtizë dhe ngarkoi tek ata që

[106] El Eganij, 14: 158, Shtëpia botuese "Sasij".
[107] El Efhaxh: ai që i ka kofshët e shëndosha, të ngjitura e shputat e këmbëve të hapura anash. El Exhlah: ai që e ka rruajtur kokën e tij nga të dy anët. El Em'ar: me pak flokë.

kishin pranuar Islamin në Sham prej Kuda'ah-it.[108] Ndërkohë Shejhu u largua dhe flamuri dridhej mbi kokën e tij …., hadithi.[109]

Atë, gjithashtu, e kundërshton ajo që ka ardhur për emërimin e Alkame ibn Alathe El Kelbijit, pas tradhtisë së tij, siç përmendet tregimi i tij te libri "El Eganij" dhe El Isabe,[110] së bashku me biografinë e tij. Tregimi është si vijon:

Alkame e pranoi Islamin në periudhën e të Dërguarit të Allahut dhe arriti shoqërimin e tij. Në kohën e Ebu Bekrit u bë tradhtar. Ebu Bekri dërgoi tek ai Halidin dhe Alkame ia mbathi prej tij.

Kanë thënë: Pastaj u rikthye përsëri në islam.

Në librin "El Isabe" thuhet: "Në kohën e Umerit (Alkame) ka pirë alkool, u bë tradhtar dhe vajti tek romakët. Mbreti i romakëve e nderoi dhe i tha atij: "Ti je djali i xhaxhait i Amir ibn Et Tufejl." Ndërkohë ai u zemërua e tha: "Nuk më duket se njihem veçse me emrin Amir." Kështu që u kthye dhe pranoi Islamin."

Në "El Eganij" dhe "El Isabe" dhe termi është i të parit, thuhet: "Kur Alkame ibn Alathe erdhi në Medine,

---

[108] Kuda'ah: Fise të mëdha: Hajdan, Bahra, Bela, Xhuhejne. Biografia e tyre është tek libri *Xhumhuretul-Ensab,* i Ibn Hazmit, 440-460. Vendbanimet e tyre kanë qenë në Shahr, në Nexhran, pastaj në Sham. Kanë pasur një mbretëri që shtrihej ndërmjet Shamit, Hixhazit e deri në Irak. Kthehu Lëndës "Kuda'ah", "Fjalori i fiseve arabe", 3: 957.

[109] *El Eganij*, 14: 158, Shtëpia botuese "Sasij". Ibn Hazim e përmblodhi atë te "Xhumhuretu Ensabul Arab", 284.

[110] Biografia e tij tek "El Isabe", 2: 496-498. "El Eganij", 15: 56, Shtëpia botuese "Sasij". Tregimi i arratisjes së Alkamesë dhe Amir tek libri "El Eganij", 15: 50-55 dhe te "Xhumhuretu Ibn Hazim", 284.

ishte larguar prej Islamit dhe ishte shok i Halid ibn El Velijdit, atë e takoi Umer ibn Hatabi (*Allahu qoftë i kënaqur me të!)* në mesxhid, në mes të natës. Umeri, i cili e ngjasonte atë me Halidin, e përshëndeti duke kujtuar se ishte Halidi.

Umeri i tha atij: "U nda me ty?"

Alkame iu përgjigj: "Kështu ndodhi."

Umer ibn Hatabi i tha: "Pasha Allahu, s'është gjë tjetër veçse garë kundër teje dhe smirë e jotja."

Umeri i tha atij: "A nuk ke ndihmë për këtë?"

Alkame tha: "Zoti na ruajt! Është detyrë e jona që Umerin ta dëgjojmë, t'i bindemi e të mos e kundërshtojmë udhëheqjen e tij."

Kur u gdhi, Umeri *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)* ftoi njerëzit. Erdhi edhe Halidi, së bashku me Alkamen. Alkame u ul pranë Halidit, ndërkohë Umeri u kthye nga Alkame dhe i tha atij: "Turp të kesh o Alkame, për atë që ke thënë për Halidin!"

Alkame u kthye nga Halidi dhe i tha: "O Ebu Sulejman, a e kam bërë këtë?

Halidi i tha: "I mjeri ti! Pasha Allahun! Nuk të kam takuar ka kohë, deri në momentin që u takove me një burrë."

Alkame tha: "E pa atë, pasha Allahun. Pastaj u drejtua nga Umeri *(Allahu qoftë i kënaqur me të!)* e i tha: "O prijësi i besimtarëve! Nuk kam dëgjuar veçse të mira."

Umer ibn Hatabi i tha "Po! Sigurisht. A dëshiron që të të emëroj në Hauran?"[111]

Alkame tha "Po." Umeri e emëroi atë në Hauran dhe vdiq atje.

Te libri "El Isabe" shton:

Umeri tha: "Sikur të kishte pas meje shembuj të mendimit tënd, do të ishte më e dashur për mua se sa kjo dhe ajo."

Këto që transmetuam ishin një realitet historik. Mirëpo dijetarët e shkollës së kalifave u mbështetën në ato që transmetuan dhe zbuluan prej këtyre transmetimeve një kriter për njohjen e sahabëve të të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, duke futur në numrin e sahabëve të sajuar Sejf ibn Umer, i akuzuar për ateizëm, siç e studiuam te libri ynë "Njëqind e pesëdhjetë sahabë të sajuar".

Pas studimit të mendimit të dy shkollave, në lidhje me përkufizimin e termit *sahab*, le të studiojmë çështjen e drejtësisë së sahabëve tek këto dy shkolla.

[111] Hauran: Qark i madh nën varësinë e Damaskut, me shumë fshatra dhe ferma. "Fjalori i vendeve", 2: 358.

Drejtësia e sahabëve sipas dy shkollave

1- Mendimi i shkollës së kalifave, në lidhje me drejtësinë e sahabëve

Shkolla e kalifave mendon se të gjithë sahabët janë të drejtë dhe janë burim për të gjithë për marrjen e orientimeve të tyre fetare. Imami i *xherhit* dhe i *ta'dilit,* El Hafidh Ebu Hatim Er Razij,[112] në hyrje të librit të tij ka thënë: "As'habët e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* janë ata që dëshmuan shpalljen dhe zbritjen, e dinin shtjellimin dhe komentimin. Janë ata që i zgjodhi Allahu i Lartësuar në shoqërimin e Profetit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, për përkrahjen e tij, për ngritjen e fesë dhe për vënien drejtësisë. Allahu i Lartësuar i bëri ata as'habë të kënaqur për të dhe i bëri ata për ne udhërrëfyes e shembuj. Ata mësuan prej Profetit çfarë i erdhi prej Allahut të Lavdishëm e të Lartësuar, çfarë ligjëroi e legjitimoi, gjykoi e bëri fakt të kryer, mbylli plagët, urdhëroi e ndaloi, paralajmëroi dhe edukoi, i perceptuan, i përvetësuan, arritën shkallët më të larta të diturisë në fe. E mësuan urdhrin e Allahut dhe ndalesën e Tij, qëllimin e Tij

[112] Ai është Ebu Muhamed Abdu Rrahman ibn Ebu Hatim Er Razij, i cili ndërroi jetë në vitin 327 hixhri. Libri i tij i njohur "Takdimetul ma'rife li kitabi el xherhu ue ta'dil", Shtëpia botuese "Hajdar Abad", 1371 hixhri. Ne kemi përcjellë atë që ai përmend nga faqja 7 e deri te faqja 9.

me caktimin e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).* Ata janë dëshmues se prej tij kanë marrë komentimin dhe sqarimin e Librit dhe ka nxjerrë ligjet dhe rregullat e tyre prej atij Libri. Allahu i Lartësuar i nderoi ata me atë që u dhuroi atyre dhe i fisnikëroi ata me të, duke e bërë atë (Profetin) si shembullin më të mirë për ata.

Fshiu prej tyre dyshimin, gënjeshtrën, gabimin, mëdyshjen, mburrjen dhe mendjemadhësinë dhe i quajti ata të drejtët e umetit. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'an: "**Kështu, Ne ju kemi bërë një bashkësi të drejtë, që të bëheni dëshmitarë përmbi njerëzit**" I Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* e komentoi thënien e Tij "uesatan" me kuptimin "adlan" i drejtë". Ata ishin të drejtit e umetit, imamët e udhëzimit, argumentet e fesë dhe transmetuesit e Librit e Sunetit. Allahu i Lavdishëm dhe i Lartësuar e ka bërë të pëlqyeshme kapjen pas udhëzimit të tyre dhe ndjekjen e rrugës së tyre. Allahu i Lavdishëm ka thënë: **"...dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve, Ne e lëmë të ecë andej nga është nisur..."**[113] Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka nxitur transmetimin prej tij në shumë lajme. E gjejmë atë t'u drejtohet as'habëve me lutjen që i bëri Allahut të Lartësuar: *"Allahu e ndriçoftë njeriun që e dëgjon thënien time, e memorizon, e percepton atë e ia transmeton të tjerëve."*

[113] Shkolla e Ehli Bejtit *(Paqja qoftë mbi ta!)* mendon se qëllimi i gjithë kësaj janë besimtarët, siç tregon ajeti për këtë. Më pas, nëse do Allahu i Lartësuar, do ta sqarojmë më shumë këtë temë.

Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*, në një ligjëratë të tij, ka thënë: "*Atëherë le t'ia transmetojë i pranishmi prej jush munguesit. Transmetoni prej meje qoftë edhe një ajet dhe bisedoni për mua dhe mos ngurroni.*"

Pastaj sahabët *(Allahu qoftë i kënaqur me ta!)* u shpërndanë në rajone, shtete e qytete, për çlirimin e vendeve, të principatave, duke i kushtuar rëndësi gjykimit e dispozitave ligjore. Kështu që gjithsecilin prej tyre e dërgoi në vende të ndryshme, për të përçuar atë që perceptoi, e memorizoi nga i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. U përgjigjeshin pyetjeve me atë që kishin mësuar nga i Dërguari *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Qëllimi i tyre ishte i mirë, të afronin njerëzit me Allahun, t'u mësonin njerëzve detyrat, dispozitat ligjore, Sunetin, hallallin dhe haramin, derisa ata i mori Allahu i Lartësuar. Kënaqësia e Allahut, falja dhe mëshira e Tij qofshin mbi të gjithë së bashku!

Ibn Abdul Berr, në hyrje të librit të tij "El Istijab",[114] ka thënë: "Është vërtetuar drejtësia e të gjithëve." Pastaj filloi me transmetimin e ajeteve dhe të hadithеve të transmetuara për besimtarët, të ngjashme me ato që transmetuam nga Er Razij."

[114] "El Istijab fi Esmaul As'hab" të hafizit, muhadithit, Ebu Umer Jusuf ibn Abdullah ibn Muhamed ibn Abdul Berr En Nemrij El Kurtubij El Malikij, 363-463 hixhri, të cilën e kemi transmetuar nga një kopje e futnotës së librit "El Isabetu": 2.

Ibn Ethijr, në hyrje të librit "Usdul Gabe",[115] ka thënë: "…Suneti, që është boshti i shtjellimit të dispozitave ligjore, për njohjen e hallallit dhe të haramit, si dhe për çështje të tjera të fesë, konstatohet pas njohjes së personaliteteve të zinxhirit të transmetimeve dhe transmetuesve të tyre. Ata që kanë më përparësi janë as'habët e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*. Kështu që, nëse njeriu është injorant në lidhje me to, me të tjerë do të jetë edhe më injorant dhe më mohues. Si rrjedhojë, është e domosdoshme që të njihen me gjenezën dhe me gjendjet e tyre..."

Sahabët janë njëlloj, si të gjithë transmetuesit e tjerë, përveçse në xherh[116] dhe ta'dil[117], sepse të gjithë janë të drejtë dhe nuk mund të mendohet xherhi për ta.

El Hafidh ibn Haxher, në kapitullin e tretë, në lidhje me sqarimin e gjendjes së sahabëve ndaj drejtësisë, në hyrje të librit "El Isabetu",[118] ka thënë: "Ehli Suneti ka rënë dakord se ata janë të gjithë të drejtë dhe nuk e kundërshton

---

[115] "Esedul Gabe fi Mearifetus Sahabe", Ebi Hasan Izzud Dijn, Ali ibn Muhamed ibn Abdul Kerijm El Xhezrij, i njohur si Ibn Ethijr (ndërroi jetë në vitin 630 hixhri), 1: 3.

[116] Fjala "Xherh" ka edhe kuptimin "kritikë", që përdoret tek shkencat e hadhithit në lidhje me transmetuesit.

[117] Fjala "Ta'dil" ka edhe kuptimin "Lëvdim", që përdoret tek shkencat e hadithit në lidhje me transmetuesit.

[118] "El Isabetu fi Temjijz Es Sahabe", El Hafidh Shihabu Dijn Ahmed ibn Ali ibn Muhamed El Kenanij El Askelanij Esh Shafiij, i njohur si Ibn Haxher (773-852 hixhri). Jemi kthyer tek botimi i Bibliotekës Tregtare, 1358 hixhri, në Egjipt, 1: 17-22.

këtë mendim veçse një njeri që nuk mendon e është sajues…"

Nga Ebu Zer'ah transmetohet: "Nëse sheh dikë që thotë të meta për ndonjë prej as'habëve të të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* dije se është ateist. Kjo sepse i Dërguari është një e drejtë, Kur'ani një e drejtë, ajo që erdhi me të është një e drejtë dhe të gjithë këtë ne na e përcollën sahabët. Ndërsa ata dëshirojnë të plagosin xherh dëshmitarët tanë, për të shfuqizuar Librin dhe Sunetin. Por ata janë më meritues për xherh dhe janë ateistë."[119]

2- Mendimi i shkollës së Ehli Bejtit *(Paqja qoftë mbi ta!)* për drejtësinë e sahabëve

Shkolla e Ehli Bejtit *(Paqja qoftë mbi ta!)*, bazuar te Kur'ani, mendon se midis sahabëve ka besimtarë që Allahu i lavdëroi në Kur'anin Fisnik dhe, në Besëlidhjen e Pemës, thotë: **"Allahu është i kënaqur me ata besimtarë, kur t'u betuan me besnikëri nën hijen e pemës. Ai e**

[119] "El Isabetu", 1: 18. Dhe Ebu Zer'ah është Abijdullah ibn Abdul-Kerijm ibn Jezijd. Ibn Haxher te libri "Takrijbut Tehdhijb", 2: 536, Biografia 1479, ka thënë: "Imam memorizues, i besueshëm e me nam, prej shtresës së njëmbëdhjetë të transmetuesve. Vdiq në vitin dyqind e gjashtëdhjetë e katër. Transmetuan prej tij autorët e librave të saktë, si: Muslimi, Tirmijdhiu, Nisaij dhe Ibn Maxheh. Them: "Nuk e di çfarë thotë imam Ebij Zer'ah, në të drejtë të hipokritëve të as'habëve të të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*."

dinte se ç'kishte në zemrat e tyre, prandaj u dha atyre qetësi dhe i shpërbleu me një fitore të afërt."[120]

Allahu e veçoi lavdërimin e besimtarëve që ishin të pranishëm në Besëlidhjen e Pemës dhe nuk përfshiu hipokritët, që e paraqitën atë, si për shembull Abdullah ibn Ebu Eus El Haula.[121]

Gjithashtu, në ajete të shumta të Kur'anit, përmenden mynafikët, të cilët Allahu i Lartësuar i qorton në shumë ajete, si për shembull: "**Ka beduinë në mjedisin tuaj, që janë hipokritë, por ka edhe ndër banorët e Medinës të atillë që janë këmbëngulës në hipokrizi. Ti nuk i di ata. Ne i dimë. Ne do t'i dënojmë dy herë e pastaj, do të kthehen në dënimin e madh** (në Xhehenem)**.**[122]

Në mesin e tyre ka prej atyre për të cilët Allahu thotë se janë shpifës dhe që shpifën ndaj nderit të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)*[123] *(Allahu na ruajt prej kësaj thënieje!).*

Në mesin e tyre ka persona për të cilët Allahu thotë: **"...Mirëpo, sa herë që ata shohin ndonjë tregti apo lojë,**

---

[120] Sure "El Fet'h", ajeti 18.

[121] Kthehu lajmit "Besëlidhja e Pemës" (Er Ridvan), tek Megazij, El Uakidij dhe Khitat të El Makrijzij.

[122] Sure "Et-Teube", ajeti 101.

[123] Fjala është për tregimin e shpifjes, ku për këtë zbritën ajetet 11-17, të sures "Nur", për pafajësinë e Aishes, për shkak të shpifjes ndaj saj, siç ka transmetuar vetë ajo, ose për pafajësinë e Marijeh për shpifjet ndaj saj, si thuhet tek pjesa e dytë e haditheve të nënës së besimtarëve, Aishes.

shkojnë tek ajo e të lënë ty në këmbë...”[124], kjo ka ndodhur në momentin që i Dërguari i Allahut ishte duke mbajtur ligjëratën e ditës së premte në xhaminë e tij.

Në mesi e tyre ka prej atyre që kanë synuar vrasjen e të Dërguarit të Allahut, në Ukabetu Hersha, gjatë kthimit të tij nga Beteja e Tubukut,[125] ose nga Haxhi i Lamtumirës.[126]

Nderimi me shoqërimin e Profetit *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* nuk është më i madh se nderimi i martesës me Profetin. Sigurisht, bashkëshoqërimi i grave të tij me të ka qenë në gradat më të larta të shoqërimit. Allahu i Lartësuar, për këtë çështje ka thënë: **“O gratë e të Dërguarit! Ato prej jush që bëjnë ndonjë turp të hapur, do të kenë ndëshkim të dyfishtë; kjo për Allahun është e lehtë. Ndërsa atyre prej jush, që binden ndaj Allahut e të Dërguarit të Tij dhe bëjnë vepra të mira, Ne do t’u japim shpërblim të dyfishtë e u kemi përgatitur begati të mëdha. O gratë e të Dërguarit! Ju nuk jeni si gratë e tjera. Nëse i frikësoheni Allahut, mos flisni**

---

[124] Sure “El-Xhumu’ah”, ajeti 11.

[125] “Musned Ahmed”, 5: 390 dhe 453. Kthehu te “Sahijh Muslim”, 8: 122-123, K. “Cilësitë e hipokritëve, Mexhmauz Zevaid”, 1: 110 dhe 9: 195. “Megazijul Uakidij”, 3: 1042.” Imtaul Esma” i El Makrijzij: 477 dhe në komentim e thënies “u morën me atë që nuk e arritën”, ajeti 74 i sures “Et-Teube” tek komentimi i “Ed Durrul Menthur” i Sujutit, 3: 258-259.

[126] Është transmetuar në hadithet e shi’itëve se kjo ka ndodhur gjatë kthimit të tij nga Haxhi i Lamtumirës dhe me rastin e Gadijr Khumit, në tokën e Xhuhfes. Kthehu te “El Bihar”, 28:97, Botim i Bibliotekës Islame, Teheran, 1392 hixhri.

me përkëdheli, që të mos ju dëshirojë ai që ka zemër epshore, por flisni drejt dhe në mënyrë të ndershme!"[127]

Për dy prej atyre bashkëshorteve, Kur'ani ka thënë: "**Nëse ju të dyja ktheheni të penduara tek Allahu, sepse vërtet që zemrat tuaja patën devijuar, Allahu do t'ju falë. Nëse ju të dyja bashkoheni kundër tij,** (dijeni se) **Allahu është Mbrojtësi i tij, Xhebraili dhe besimtarët e mirë..."** e deri te thënia e Tij: **"Allahu ka dhënë si shembull për ata që nuk besojnë, gruan e Nuhut dhe gruan e Lutit. Ato ishin të martuara me dy nga robtë Tanë të ndershëm dhe i tradhtuan ata. Prandaj, ata nuk mund t'i mbrojnë aspak nga Allahu** (Ditën e Gjykimit) **e atyre të dyjave do t'u thuhet: "Hyni në zjarr, me ata që po hyjnë!" "Allahu ka dhënë si shembull për besimtarët gruan e Faraonit, kur ajo tha: "O Zoti im! Ndërtomë një banesë tek Ti, në Xhenet... Edhe Merjemen, të bijën e Imranit..."**[128]

Ka prej atyre për të cilët Profeti *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* ka lajmëruar për ata në Ditën e Ringjalljes: *"Do të sillen burra prej umetit tim e do të çohen nga e majta. Unë do të them: O Zoti im, shokët e mi. Do të thuhet: "Vërtet ti nuk e di çfarë sajuan pas teje." Unë them siç ka thënë robi i sinqertë*: ***"Isha dëshmitar për ta sa isha në mesin e tyre dhe ndërkohë që më vdiqe mua ishe Ti***

[127] Sure "El Ahzab", ajeti 30-32.

[128] Sure "Et Tahrim", nga fillimi i sures e deri në fund.

mbikëqyrësi i tyre" Thuhet: *"Vërtet ata u kthyen nga e shkuara e tyre që kur u ndave prej tyre."*[129]

Në një transmetim tjetër thuhet: "Do të kthehen tek unë, tek burimi disa prej as'habëve të mi dhe do t'i njoh të lëkundurit ndaj meje. Ndërkohë unë do të them: "As'habët e mi." Do të më thuhet: "Nuk e di çfarë kanë sajuar pas teje?!"[130]

Tek "Sahih Muslim" lexojmë: "Do të kthehen në burimin tim burra që më kanë shoqëruar mua, saqë, kur t'i shoh, ata ikin prej meje dhe më largohen. Ndërkohë unë u them atyre: "O Zot, as'habët e mi!" Mua më thuhet: "Ti nuk e di çfarë kanë sajuar pas teje."[131]

3- Kriteri për njohjen e besimtarit dhe të hipokritit

Meqenëse në mesin e sahabëve ka pasur hipokritë, që nuk i njihte askush përveç Allahut të Lartësuar, Ai (Allahu) e lajmëroi Profetin e Tij se Aliun nuk e do veçse një besimtar dhe nuk e urren veçse një hipokrit, siç e

---

[129] El Buhari, komentimi i sures *"El Maide"*, Kreu: "O i Dërguar, transmeto atë që të është zbritur ty...", komentimi i sures "El Enbija", Et Tirmijdhij, kapitujt e Cilësive të Ringjalljes, Kreu "Çfarë ka ardhur në lidhje me çështjen e tubimit" dhe komentimi i sures "Ta Ha".

[130] El Buhari, Kitabu D*a'uaat*, Kreu "Haudhu Nebij". Ibn Maxheh, *Kitabul Menasik*, Kreu "El Hutbetu fi Jeumi En Nahr", Hadithi 5830. Kthehu tek Musned Ahmed, 1: 453, 3: 28 dhe 5: 48.

[131] Sahih Muslim, *Kitabul Fadail*,, Kreu "Ithbatu Haudh Nebijuna", Hadithi 40.

transmetoi atë: Imam Aliu *(Paqja qoftë mbi të!)*[132], nëna e besimtarëve Umu Selemeh[133], Abdullah ibn Abasi[134], Ebu

---

[132] Imam Aliu, djali i xhaxhait të të Dërguarit, Ebu Talib ibn Abdul Mutalib: Lindi brenda në Qabe, siç transmeton El Hakim, tek libri i tij "El Mustedrek", 3: 483, El Malikij te "El Fusul El Muhime", El Megazilij dhe Esh Shafiij te "El Menakib", Esh-Sheblenxhij te "Nurul Ebsar", 69, dhe ka lindur më 13 Rexheb të vitit 30, Viti i Elefantit. Atij i dhanë besëlidhjen muhaxhirinët dhe ensarët në vitin 35 hixhri. Ibn Mulxhem El Muradij e goditi atë natën e nëntëmbëdhjetë të muajit të Ramazanit, në vitin 40 hixhri, në Mihrabin e xhamisë së Kufes. Ra dëshmor në ditën e 21 të muajit Ramazan. Transmetuan prej tij autorët e Sahihave. Kthehu biografisë së tij te "El Istijab", "Esedul Gabeh" dhe "El Isabetu", f. 276, prej Xheuamiu Sijreth. Transmetimet e tij në lidhje me hipokritët te "Sahijh Muslim", 1: 61, kreu i argumentit se dashuria e Ensarëve dhe Aliut është prej besimit dhe urrejtja e tyre prej shenjave të hipokrizisë. "Sahijh Et Tirmijdhij", 13: 177, Kreu "Virtytet e Aliut". *Sunen Ibn Maxheh*, K.11, në Mukadimen e tij. *Sunenun Nisaij*, 2:271, K. "Shenjat e besimtarit" dhe "Shenjat e hipokritit", nga libri i besimit dhe legjislacioneve të tij. "Hasaisu Nisaij": 38. Musned Ahmed, 1: 84, 95 dhe 128. "Tarijkh Bagdad", 2: 255, 8: 417 dhe 16 426. "Hijletul Eulija" i Ebij Naijm, 4: 185 dhe ka thënë është hadith i saktë, i rënë dakord me unanimitet për të. Historia Islame Edh Dhehebij 2: 198, "Tarijkh Ibn Kethir", 7: 354, dhe për biografinë e tij te gjithsecili prej "El Istijab", 2: 461, "Esedul Gabeh", 4: 292, "Kenzul Ummal", 15:105 dhe "Rijadun Nadre", 2: 284.

[133] Ummu Selemeh, Hind bint Ebi Umeje ibn El Mugijre El Kureshij El Mahzumij. Ka qenë para të Dërguarit të Allahut te Ebu Selmeh bin Abdul Esed El Mahzumij. Këta të dy e kanë pranuar Islamin që herët dhe emigruan në Habeshe e më pas në Medine. Kur u plagos Ebu Selemeh në Uhud e ndërroi jetë në vitin e tretë hixhri, atë e mori për grua i Dërguari i Allahut dhe ishte e ve. Ndërroi jetë pas vrasjes së Husejnit, në vitin gjashtëdhjetë të hixhrit. Transmetuan prej saj autorët e Sahihave 378 hadithe. Kthehu biografisë së saj dhe biografisë së burrit të saj te "Esedul Gabeh" dhe "Xheuamius Sijreh", 276. "Takrijbut Tehdhijb", 2: 617. Hadithit të saj në lidhje me çështjen e hipokritëve te "Sahijhut-Tirmijdhij", 13: 168, "Musned Ahmed", 6: 292, "El Istijab", 2: 460, me metodika të ndryshme. "Tarijkh Ibn Kethir", 7: 354, "Kenzul Ummal", 6: 158, Botimi i parë.

Dherr El Giffariji[135], Enes ibn Malik[136], Imran ibn Hisijn.[137] Kjo ka qenë shumë e njohur dhe shumë e përhapur në kohën e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).*

Ebu Dherri ka thënë: "Hipokritët i kemi njohur me gënjeshtrën e tyre ndaj Allahut, ndaj të Dërguarit të Tij, në

---

[134] Abdullahi, djali i xhaxhait të Profetit, Abas ibn Abdul Mutalibi. Ka lindur tre vite para hixhretit. Ndërroi jetë në vitin gjashtëdhjetë e tetë në Taif. Autorët e Sahihave kanë transmetuar prej tij 1660 hadithe. Biografia e tij është në librin "Esedul Gabe", "El Isabe" dhe "Xheuamius Sijreh": 276.

[135] Ebu Dherr, Xhendeb ose Burejd ibn Xhunade, ose Abdullah apo Es Seken, etj. E pranoi Islamin që herët dhe u vonua në emigrim. Ishte dëshmitar i betejave të Dërguarit të Allahut pas Bedrit. Ndërroi jetë i dëbuar në Rebdheh, në vitin tridhjetë e dy hixhri. Autorët e Sahihave kanë transmetuar prej tij 281 hadithe. Biografia e tij është në librin "Et Takrijb", 2: 420, "Xheuamius Sijreh", 277 dhe pjesa e dytë e Abdullah ibn Sebe.

[136] Enes ibn Malik ibn En Nader El Ensarij El Hazrexhij. Transmetohet se i ka shërbyer të Dërguarit dhjetë vjet. Ka pasur dy krahët e tij të zbardhur, si rezultat i duasë së Imam Aliut, sepse fshehu dëshminë e tij rreth ndodhisë së Gadijrit. Imami u lut që ta godasë atë Allahu me të bardhë që nuk e mbulon as mbulesa, e cila tregohet tek libri "El-I'lak En-Nefsije", 122 dhe shtjellimi i tij te "Sharh Nehxhul-Belaga", 4: 388. Ndërroi jetë në Basra, pas të nëntëdhjetave. Autorët e Sahihave kanë transmetuar prej tij 2286 hadithe. Biografia e tij është në librin "Esedul Gabe", "Et Takrijb" dhe "Xheuamius Sijreh", 276. Transmetimi i tij në lidhje me hipokritët tek "Kenzul Ummal", 7: 140, Botimi i parë.

[137] Ebu Nexhijd, Imran ibn Hasijn El Huzaij El Ka'bij. E pranoi Islamin vitin e Hajberit. E ka shoqëruar Profetin dhe shkoi në Kufe. Ndërroi jetë në Basra, në vitin 52. Autorët e Sahihave kanë transmetuar prej tij 180 hadithe. Transmetimi i tij në lidhje me hipokritët te "Kenzul Ummal", 7: 140, Botimi i parë. Biografia e tij është në librin "Et Takrijb", 2: 72 dhe "Xheuamius Sijreh", 277.

braktisjen e namazeve dhe në urrejtjen ndaj Ali ibn Ebu Talibit."[138]

Ebu Said El Huderij ka thënë: "Ne, ensarët, i kemi njohur hipokritët me urrejtjen e tyre ndaj Ali ibn Ebu Talibit."[139]

Abdullah bin Abasi ka thënë: "Ne i kemi njohur hipokritët në kohën e të Dërguarit të Allahut me urrejtjen e tyre ndaj Ali bin Ebu Talibit."[140]

Xhabir ibn Abdullah El Ensarij ka thënë: "Nuk i njihnim hipokritët veçse me urrejtjen për Ali ibn Ebu Talibin."[141]

E tërë kjo për thënien e të Dërguarit të Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)* që ka thënë për Imam Aliun: "O Allah i Plotpushtetshëm,

---

[138] "Mustedrek Es Sahijhejn", 3: 129. "Kenzul Ummal", 15: 91.

[139] Ebu Said, Sa'ad ibn Malik ibn Senan El Hazrexhij El Hudrij. Ka qenë dëshmitar i Betejës së Hendekut e të tjerave pas tyre. Ka vdekur në Medine në vitin gjashtëdhjetë e tre, ose gjashtëdhjetë e katër ose gjashtëdhjetë e pesë. Po ashtu thuhet në vitin shtatëdhjetë e katër. Autorët e Sahihave kanë transmetuar prej tij 1170 hadithe. Biografia e tij është në librin "Esedul Gabe", 2: 289, "Et Takrijb", 1: 289 dhe "Xheuamius Sijreh": 276. Transmetimi i tij për hipokritët jepet te "Sahijhu Tirmijdhij", 13: 167 dhe "Hilijtu e Ebu Naijm", 6: 284.

[140] Në "Historinë e Bagdadit", 3: 153 ka thënë: "Ishin tek Ibn Mes'udi, ndërkohë Ibn Abasi recitoi *Mrekullohet bujku me tokën e kultivuar prej jobesimtarëve*. Ali bin Ebu Talib ka thënë: "Vërtet ne i kemi pas njohur…" Hadithi.

[141] Xhabir ibn Abdullah ibn Umer El Ensarij Es Silmij. Sahabij, i biri i sahabiut. Është dëshmitar i besëlidhjes së Akabeh me babain e tij, si dhe dëshmitar i 17 betejave me Profetin e në Sifijn me Imam Aliun. Vdiq në Medine, pas të shtatëdhjetave. Autorët e Sahihave kanë transmetuar prej tij 1540 hadithe. Biografia e tij është në librin "Esedul Gabe", 1: 256-257, "Et Takrijb", 1: 122 dhe "Xheuamius Sijreh": 276. Transmetimi i tij, për hipokritët jepet te *El Istijab* 2: 464, *Rijadun Nadreh*, 2: 284, *Tarijkhu Dhehebij*, 2: 198. "Mexhmau Zeuaid", 9: 133 dhe thënia e tij: "Nuk i kemi pas njohur hipokritët tanë te ensarët..."

duaje atë që do atë (Aliun) dhe bëhu armik i atij që është armik i atij (Aliut).”[142]

Ata rezervohen në marrjen e udhëzimeve të fesë së tyre nga një sahab që ka qenë armik i Aliut dhe nuk e ka dashur atë, nga frika se sahabi mund të jetë prej hipokritëve, të cilët nuk i njeh askush përveç Allahut të Lartësuar.

[142] “Sahijhu Tirmijdhij”, 13: 165, Kreu “Fadailu Al”i. *Sunen Ibn Maxhah*, Kreu “Përparësia e Aliut”, Hadithi 116. “Hasaisun Nisaij”: 4 dhe 30. “Musned Ahmed”, 1: 84, 88, 118, 119, 152, 330 dhe 4: 281, 368, 370, 372 dhe 5: 307, 347, 350, 358, 361, 366, 419, 568. “Mustedrek Es-Sahijhejn”, 2: 192 dhe 3: 9. “Rijadun Nadre”, 2: 222-225. “Tarhul Bagadad”, 7: 377 dhe 8: 290 dhe 12: 343 e shumë burime të tjera.

SEKRETET E HAXHIT, NË NJË DIALOG NDËRMJET IMAM ZEJNUL ABIDIJNIT

(Paqja qoftë mbi të!) DHE ESH SHIBLIJIT

Hyrje

Nga Ehli Bejti i pagabuar, të cilët Allahu i ka pastruar plotësisht, ka shumë transmetime për çështjen e Haxhit. Po ashtu, ka shumë ndodhi të përmendura, nga ato që janë të mbushura me njohje të qartë e të lartë rreth adhurimit të Haxhit, që është një prej shtyllave të Islamit. Nga Ali ibn Ibrahimi, nga babai i tij, nga Abdullah ibn Es Salti, nga Hammad ibn Isa, nga Harijz ibn Abdullahi, nga Zurarah se Ebu Xha'fer *(Paqja qoftë mbi ta!)* transmetohet: "*Islami është ndërtuar mbi pesë shtylla: namazin, zekatin, Haxhin, agjërimin dhe vilajetin (ndjekjen e Ehli Bejtit) …*"[143]

Një transmetim i tillë, me fraza të ndryshme, është përmendur edhe tek Sahihat e Ehli Sunetit, si dhe tek librat e tyre, ku i Dërguari i Allahut *(Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe familjen e tij!)* ka thënë: "*Islami është ndërtuar mbi pesë shtylla: Shehadeti: "S'ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është robi dhe i dërguari i Tij", falja e namazit, dhënia e zekatit, Haxhi në Shtëpinë e Shenjtë dhe agjërimi i Muajit të Ramazanit.*"[144]

Kështu që Haxhi është një prej shtyllave themelore tek të gjithë medh'hebet islame. Për këtë ai gëzon një

[143] Shih: "Usulul El Kafij", vëll. 2, f. 18, botoi Shtëpia botuese e librave islame, Teheran. "Uesailu Shija", vëll. 1, f.13, kapitujt e adhurimeve, K. 1, Hadithi 2, botoi Instituti i Alul Bejtit *(Paqja qoftë mbi të!)* për ringjalljen e trashëgimisë.

[144] Shih: "Sahih Muslim", me shpjegimin e Imam Neveviut, 1: 177, Shtëpia botuese "El Fikr". "Kenzul Ummal", 1: 28, Hadithi 28, "Muessetu Risale", Bejrut.

rëndësi shumë të madhe, qoftë nga ana e dispozitave ligjore, ritualeve, njohurive morale dhe gjurmëve të tij, tek besimtarët.

Ai që dëshiron të kryejë Haxhin apo umren, nuk duhet të mjaftohet vetëm me njohjen e dispozitave ligjore, ritualeve, situatave dhe mënyrën e kryerjes së tij. Është detyrë e tij që të njihet me detyrat që dalin prej këtyre ritualeve e obligimeve, shpirtërisht e moralisht, për veten e tij dhe për të tjerët. Në këtë mënyrë, Haxhi do të këtë një paraqitje të mishëruar me besimin në adhurim, vepër e thënie e një imazh të mrekullueshëm shpirtëror. Këto imazhe e shoqërojnë haxhiun që në çastet e para të fillimit të këtij obligimi të begatë e deri në kthimin e tij në atdhe tek të afërmit e tij.

Sa adhurim i bukur është ai, i cili lë gjurmët e tij tek njeriu, tek besimi i tij në Allahun e Madhëruar, si edhe në sjelljen dhe në marrëdhëniet e tij me njerëzit!

Është e vërtetë se Haxhi është një rilindje për njeriun, nëse ai ka mundësi të përjetojë gjurmët dhe kuptimet e tij dhe nëse e hap zemrën e tij për pranimin e nureve të tij.[145]

Imam Zejnul Abidijni ia bëri të qartë Shiblijut[146] konceptet e larta të Haxhit.

---

[145] Kështu është në një transmetim, që e ka transmetuar eruditi El Mexhlisij *(Allahu e mëshiroftë atë!)*: "Nuk ikën prej Haxhiut drita e Haxhit, përderisa nuk mëkaton.", "Biharul Enuar", 10: 96, Muessetul Uefa, Bejrut.

[146] Megjithëse u përpoqa aq sa kisha mundësi prej burimeve që kisha, nuk kam hasur në një biografi të përshtatshme për këtë Shiblin. Kam përshtypjen se ai është nga të panjohurit e që nuk është përmendur në

Kur Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* u kthye nga Haxhi, atë e priti një Haxhi´, i quajtur Esh Shiblij.

Imam Zejnul Abidijni i tha atij: "A ishe në Haxh, o Shiblij?"

Shiblij i tha: "Po, o nipi i të Dërguarit të Allahut."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "A zbrite në Mijkat?[147] A i zhveshe rrobat e qepura? A more gusul?"

Shiblij i tha: "Po."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Kur zbrite në Mijkat, a bëre nijet që ti po heq rrobën e mëkatit dhe po vesh rrobën e bindjes e të nënshtrimit?"

Shiblij i tha: "Jo."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Kur e zhveshe rrobën tënde të qepur, a bëre nijet që ke hequr rrobën e dyfytyrësisë, të hipokrizisë dhe hyrjes në dyshime?"

Shiblij i tha: "Jo."

---

librat biografikë të haditheve e personaliteteve tek të dy grupet. Ajo që kam mundur të gjej përmes kërkimit tim është një person tjetër, që quhet Ebu Bekr Esh Shiblij El Bagdadij dhe emri i tij Dulf ibn Xhahdar. Thuhet se quhet Xha'fer ibn Junus. Thuhet se quhet Xha'fer ibn Dulf, i cili ndërroi jetë në Bagdad në vitin 334 dhe ishte tetëdhjetë e ca vjeç. Shih: "El Gadijr", 11: 149. "Sejr A'lam En Nubela", 15: 367. "El Iber", 2:50. "Mustedrek Sefijnetul Bihar", 5: 316. Për këtë le të mjaftohemi me përmendjen e këtyre përmbajtjeve e të nxjerrim mësime prej tyre e që na bën të qartë një aspekt të madh të sekreteve të këtij obligimi të shenjtë e udhëtimi të begatë.

[147] Mikajti është vendi ku Haxhinjtë veshin Ihramin para se të hyjnë në Mekë (Sh.P)

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Po kur more gusul, a bëre nijet që ti ke bërë gusul (pastrim të përgjithshëm) për të gjitha gabimet e mëkatet?"

Shiblij i tha: "Jo."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Atëherë nuk ke zbritur në Mijkat, as nuk je zhveshur prej rrobave të qepura dhe as nuk ke marrë gusul!"

Pastaj imami tha: "A u pastrove? A e veshe Ihramin? A vendose të bësh Haxhin?"

Shiblij i tha: "Po."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Po në momentin që u pastrove, veshe Ihramin dhe vendose të bësh Haxhin, a bëre nijet se ti u pastrove me nurin[148] e pendimit të sinqertë për Allahun e Lartësuar?"

Shiblij i tha: "Jo."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Kur veshe Ihramin, a bëre nijet se ti ia ke bërë haram vetes tënde çdo gjë të ndaluar, që e ka ndaluar Allahu?"

Shiblij i tha: "Jo."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Në momentin që vendose të bësh Haxhin, a bëre nijet që ti ke zgjidhur çdo lidhje tjetër, me përjashtim të asaj me Allahun?"

Shiblij i tha: "Jo."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "As nuk je pastruar, as nuk ke veshur Ihramin dhe as nuk je lidhur me Haxhin!"

---

[148] *Bi Nuretin* në një transmetim dhe *Bi Nurin* në një transmetim tjetër.

Pastaj imami i tha: "A hyre në Mijkat? A i fale dy rekate namaz për Ihramin? A e shqiptove Lebejken?"

Shiblij i tha: "Po."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Kur hyre në Mijkat, a bëre nijet qëllimin e vizitës?"

Shiblij i tha: "Jo."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Kur fale dy rekatet, a bëre nijet që të afrohesh tek Allahu me veprën më të mirë se namazi dhe me të mirat më të mëdha të robëve?"

Shiblij i tha: "Jo."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Po kur the Lebejken, a bëre nijet se po shqipton vetëm për Allahun e Lavdishëm, me plot bindje dhe se heq dorë nga çdo mëkat?"

Shiblij i tha: "Jo."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Nuk ke hyrë në Mijkat, as nuk je falur dhe as nuk ke thënë Lebejken!"

Pastaj i tha: "A hyre në Harem? A e pe Qabenë? A u fale?"

Shiblij i tha: "Po."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Kur hyre te Haremi, a bëre nijet që do t'ia ndalosh vetes tënde çdo përgojim të myslimanëve?"

Shiblij i tha: "Jo."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Kur mbërrite në Mekë, a bëre nijet me zemrën tënde se ti vërtet synon Allahun?"

Shiblij i tha: "Jo."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Nuk ke hyrë në Qabe, nuk e ke parë Qaben dhe as nuk je falur!"

Pastaj tha: "A bëre tauaf rreth Shtëpisë (Qabesë)? A i preke ruknet (shtyllat)? A e bëre Sa'jin?"

Shiblij i tha: "Po."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Kur e bëre Sa'jin, a bëre nijet se ti po ikën drejt Allahut dhe se i Gjithëdituri i të fshehtave është më i Dituri ndaj teje?

Shiblij i tha: "Jo."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Nuk e ke bërë tauafin rreth Shtëpisë, as nuk i ke prekur shtyllat dhe as nuk e ke bëre Sa'jin!"

Pastaj imami i tha: "A e preke me dorë Gurin e Zi, a qëndrove në Mekamin e Ibrahimit *(Paqja qoftë mbi të!)* e i fale në të dy rekate?"

Shiblij i tha: "Po."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* bërtiti aq fort, gati sa u shkëput nga kjo botë. Pastaj tha: "Aaahhh, Aaahhh."

Pastaj Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Ai që e takon me dorë Gurin e zi, është përshëndetur me Allahun e Lartësuar, kështu që mendo o i mjerë! Mos e humb shpërblimin më madhështor të asaj që është Madhështuar, të kundërshtosh përshëndetjen me kundërvajtjen. Vepruesi i haramit është njësoj me mëkatarët."

Pastaj Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "A bëre nijet kur qëndrove tek Mekami i Ibrahimit

(Paqja qoftë mbi të!) se ti ke qëndruar mbi çdo bindje e nënshtrim dhe u zmbrapse nga çdo kundërshtim?"

Shiblij i tha: "Jo."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Kur fale në të dy rekate, a bëre nijet se ti do të falesh me faljen e Ibrahimit *(Paqja qoftë mbi të!)* dhe e ule me detyrim hundën e shejtanëve?"

Shiblij i tha: "Jo."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Atëherë nuk e ke përshëndetur me shtrëngimin e duarve Gurin e Zi, as nuk ke qëndruar në Mekam dhe as nuk i ke falur në të dy rekate!"

Pastaj Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "A pate nderin të mirëpritesh tek pusi i Zemzemit e të pish prej ujit të tij?"

Shiblij i tha: "Po."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "A bëre nijet[149] se do të nderosh me bindje e nënshtrim, duke e shmangur shikimin nga mëkati?"

Shiblij i tha: "Jo."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Nuk e ke nderuar e nuk e ke respektuar atë dhe as nuk ke pirë prej ujit të tij!"

Pastaj Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "A e bëre Sa'jin ndërmjet Safasë dhe Mer'uas, ece dhe u lëkunde ndërmjet tyre?"

Shiblij i tha: "Po."

[149] Këtu "bëre nijet" dhe në një kopje tjetër thuhet: "a bëre nijet".

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "A bëre nijet se je ndërmjet shpresës e frikës?"

Shiblij i tha: "Jo."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Nuk e ke bërë Sa'jin, as nuk ke ecur dhe as nuk je lëkundur ndërmjet Safasë dhe Mer'uas!"

Pastaj Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "A dole në Mina?"

Shiblij i tha: "Po."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "A bëre nijet që t'i sigurosh njerëzit prej gjuhës, zemrës dhe dorës tënde?"

Shiblij i tha: "Jo."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Atëherë nuk ke dalë në Mina!"

Pastaj Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "A qëndrove në Arafat, a u ngjite në Malin e Mëshirës, a u njohe me luginën Nemreh dhe a iu lute Allahut të Lavdishëm, tek Mejli dhe Xhemerati?"

Shiblij i tha: "Po."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Kur qëndrove në Arafat a e njohe Allahun e Madhëruar me dije? A e mësove se Allahu do ta marrë librin tënd dhe Ai është i Mirinformuar për zemrën tënde dhe të fshehtat e tua?

Shiblij i tha: "Jo."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Kur u ngjite te Mali i Mëshirës së Allahut, a bëre nijet që Allahu

të mëshirojë çdo besimtar e besimtare dhe të jetë Kujdestari i çdo myslimani e myslimaneje?"

Shiblij i tha: "Jo."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "A bëre nijet në luginën Nemretu se vërtet ti nuk urdhëron deri sa të urdhërohesh dhe se nuk ndalon, deri sa të ndalohesh?"

Shiblij i tha: "Jo."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Në momentin që qëndrove në el aleme e në Nemerat, a bëre nijet se ata janë dëshmuesit e tu të bindjeve e të nënshtrimeve, mbrojtësit e tu me mbrojtësit e urdhrit të Zotit të qiejve?"

Shiblij i tha: "Jo."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Atëherë nuk ke qëndruar në Arafat, as nuk je ngjitur në Malin e Mëshirës, as nuk je njohur me Nemretun, as nuk je lutur dhe as nuk ke qëndruar tek Nemeratët!"

Pastaj Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Kalove ndërmjet dy majave të larta, përpara largimit tënd fale dy rekate, ece drejt Muzdelifesë, more në të guralecët dhe kalove në Mesh'arul Haram?"

Shiblij i tha: "Po."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Para se të falje dy rekate, a bëre nijet se ai është një namaz falënderimi në natën e dhjetë, që mohon çdo vështirësi dhe lehtëson çdo lehtësi?"

Shiblij i tha: "Jo."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Gjatë kohës që shkoje ndërmjet dy majave dhe nuk anoje as djathtas e as majtas, a bëre nijet që të mos anosh nga feja jote e drejtë as majtas e as djathtas, as me zemër, as me gjuhë, as me shqisat dhe as me organet e tjera të tua?"

Shiblij i tha: "Jo."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Kur shkove në Muzdelife dhe more prej saj guralecët, a bëre nijet se vërtet ti ke zhveshur nga vetja jote çdo mëkat e padituri dhe çdo dituri e vepër është bërë e qëndrueshme?"

Shiblij i tha: "Jo."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Ndërkohë që kalove në Mesh'arin e Shenjtë, a bëre nijet se vërtet ti ke ndier në zemrën tënde simbolin e banorëve të devotshëm e që i frikësohen Allahut të Lavdishëm e të Lartësuar?"

Shiblij i tha: "Jo."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Atëherë nuk ke kaluar ndërmjet dy majave, nuk ke falur dy rekate, nuk ke vajtur në Muzdelife, as nuk more prej saj guralecët dhe as nuk ke kaluar në Mesh'arul Haram!"

Pastaj Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Arrite në Mina, i gjuajte gurët, e rrojte kokën, e preve kurbanin tënd, u fale në Mesxhidin El Khijf, u ktheve në Mekë dhe a e bëre tauafin e Ifades?"

Shiblij i tha: "Po."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "A bëre nijet në momentin që arrite në Mina, që gjuajte

guralecët, se vërtet ti e ke arritur kërkesën tënde dhe se Zoti yt ka plotësuar për ty çdo nevojë tënden?"

Shiblij i tha: "Jo."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Para se të gjuaje guralecët, a bëre nijet se vërtet ti ke gjuajtur armikun tënd, Iblisin dhe e zemërove atë me Haxhin tënd?"

Shiblij i tha: "Jo."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Ndërkohë që e rrojte kokën tënde, a bëre nijet se vërtet ti je pastruar nga pisllëqet dhe nga prirja e birit të Ademit e dole prej mëkateve ashtu siç të ka lindur nëna jote?"

Shiblij i tha: "Jo."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Ndërkohë që u fale në Mesxhidin El Khijf, a bëre nijet se ti nuk i frikësohesh askujt tjetër përveç Allahut të Lartësuar dhe mëkatit tënd dhe se nuk shpreson tjetër me përjashtim të Mëshirës së Allahut të Madhëruar?"

Shiblij i tha: "Jo."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Para se të prisje kurbanin tënd, a bëre nijet se ti ke prerë laringun e babëzisë me të cilën ishe lidhur dhe se ndoqe sunetin e Ibrahimit *(Paqja qoftë mbi të!),* sunetin për atë që vjen pas tij dhe e afron atë tek Allahu i Lartësuar? Ai bëri kurban djalin e tij, frytin e thalbit të zemrës së tij, borzilokun e zemrës së tij, Haxhiun e tij."

Shiblij i tha: "Jo."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Ndërkohë që u ktheve në Mekë dhe e bëre tauafin e

Ifades, a bëre nijet se ti u mbushe nga Mëshira e Allahut të Lartësuar, u ktheve në bindje e nënshtrim ndaj tij, i kapur me dashurinë e Tij, i kreve obligimet e Tij, e u afrove tek Allahu i Lartësuar?"

Shiblij i tha: "Jo."

Imam Zejnul Abidijni *(Paqja qoftë mbi të!)* i tha: "Atëherë nuk ke arritur në Mina, as nuk i ke gjuajtur guralecët, as nuk e ke rrojtur kokën dhe as nuk e ke kryer[150] kurbanin tënd, as nuk je falur në Mesxhidin El Khijf, as nuk e ke bërë tauafin e Ifades, as nuk je afruar. Kështu që kthehu, sepse vërtet ti nuk e ke kryer Haxhin!"

Kështu që Esh Shiblij shpërtheu në të qara për ato që kishte humbur në Haxhin e tij dhe vazhdoi të mësojë deri sa e kreu Haxhin me njohuri e siguri. Përfundoi.[151]

[150] Këtu "Nusukeke" dhe në një botim tjetër "Dhebahte".

[151] "Mustedrek El Vesail", 10: 166-172, transmetuar nga libri "Sharhun Nakhbeh".

PASQYRA E LENDES

Salavati mbi Muhamedin dhe familjen e tij.....7

Mirësitë e salavatit mbi Profetin dhe familjen e tij.....9

Mënyra e salavatit për Profetin.....13

Festimet në përkujtim të profetëve dhe njerëzve.....20

Mospajtimi rreth festimeve në përkujtim të profetëve dhe njerëzve të mirë të Allahut.....21

Përhapja e bereqetit prej Ademit dhe festimi në përkujtim të tij.....26

Zanafilla e ndjelljakeqes dhe e bereqetit të një vendi.....28

Bereqetet e ditës së premte *(xhuma*).....29

Mirësitë e Muajit të Ramazanit.....30

Mus'hafi tek transmetimet.....32

Planet dhe linjat e kërkimit studimor.....33

Mus'hafi.....34

Në terminologjinë e sahabëve.....36

Në transmetimet e Imamëve të Ehli Bejtit.....37

Në transmetimet e shkollës së kalifave.....38

Njohja e mus'hafit me gjithçka që është shkruar dhe është vendosur mes dy kapakëve, me emrin *Libri me kapak*.....39

Termi *Mus'haf* në terminologjinë e popujve të mëparshëm.....40
Emërtimi i librave fetarë te popujt e mëparshëm me emrin *mus'haf*.....40
Mus'hafi i Fatimes vajzës së të Dërguarit të Allahut.....42
Mesahifus-Sahabe (Librat e shokëve).....43
Mus'hafi i nënës së besimtarëve, Aisheja.....43
Mus'hafi i nënës së besimtarëve, Hafsa.....44
Mus'hafi i të Dërguarit të Allahut.....44
Politika e zhveshjes së Kur'anit, nga hadithi i të Dërguarit të Allahut.....46
El-Beda.....49
El-Beda në gjuhësi dhe në terminologji.....51
El-Beda në Kur'anin e Shenjtë.....52
Komentimi i ajeteve.....55
El-Beda, në transmetimet e Shkollës së kalifave.....64
El-Beda, në transmetimin e imamëve të Ehli Bejtit.....66
Ndikimi i bindjes me El-Beda.....69
Sahabi dhe drehtësia e tij.....70
Përkufizimi (njohja) e *sahabit* tek dy shkollat.....72
Njohja e *sahabit* në shkollën e kalifave.....72
Përkufizimi i termit *sahab* te shkolla e Ehli Bejtit.....73

Kriteri i tyre për njohjen e sahabit dhe diskutimi i tij.....74
Diskutimi i rregullit të njohjes së sahabit.....75
Drejtësia e sahabëve sipas dy shkollave.....80
Mendimi i shkollës së kalifave, në lidhje me drejtësinë e sahabëve.....80
Mendimi i shkollës së Ehli Bejtit për drejtësinë e sahabëve.....84
Kriteri për njohjen e besimtarit dhe të hipokritit.....89
Sekretet e Haxhit, në një dialog ndërmjet imam Zejnul Abidinit dhe Esh Shiblijit.....93
Pasqyra e lëndës.....103

نام کتاب:**على مائدة الكتاب و السنة**



نویسنده:**جعفر سبحانی**

تیرانا:**2014**

نام كتاب: على مائدة الكتاب و السنة

نويسنده: جعفر سبحانى

مترجم: ولنت مريا

ويرايش: يريدا كولا

مقابله: ويولسا كاراى

صفحه بندى: صبريه فزا

ناشر: جمعيت النسيم

تيرانا: 2014